



BASHKËPUNIMI NDËRPARLAMENTAR



Ministrja Mimi Kodheli merr pjesë në konferencën rajonale të Kartës së Adriatikut

"Shqipëria i kushton rëndësi bashkëpunimit rajonal, si një shtyllë kryesore e Mbrojtjes"

faqe 4-5

MBËSHTETJA NGA TARDIOLI

NATO garanton ndihmë për nevojat e Mbrojtjes që ka Shqipëria

faqe 3

FAZA E TRETË

Ministrja Kodheli ndjek nga afër aksionin për pastrimin e territorit

"Qortim për të gjithë ata që e konsiderojnë mjedisin një gjë të huaj"

faqe 3

VIZITA



Gjeneralmajor Bazo viziton Komandën e FT të NATO-s në Izmir

U diskutua me drejtuesit më të lartë për eksplorimin e fushave të reja të bashkëpunimit

faqe 3

ROLI I VEÇANTË I SHQIPËRISË

Shqipëria merr kryesinë e "Kartës së Adriatikut", A5: Prioritetet e NATO-s për rajonin

Ministrja Kodheli drejton ministerialin e Mbrojtjes SHBA-Karta e Adriatikut (A5) në Bruksel



faqen 3

Ukraina, Aftësitë Mbrojtëse dhe Afganistani, ishin fokusi i axhendës

Zhvillohet në Bruksel ministeriali i Mbrojtjes së vendeve të NATO-s

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Rasmussen: Që nga samiti i Lisbonës i vitit 2011, kemi arritur shumë dhe tani kemi nevojë të ruajmë vrullin drejt samitit të Uellsit dhe më gjerë



faqen 2

PULËBARDHAT "PLUSKOJNË" NË VALËT VIRTUALE TË QENDRËS SË SIMULIMEVE

Mbyllet me sukses stërvitja "PULËBARDHA 14-1"



Qëllimi i stërvitjes "Pulëbardha 14-1" ishte rritja e ndërveprueshmërisë së institucioneve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në det, nëpërmjet operimit dhe koordinimit sa më të shpejtë për përballimin e problematikave të ndryshme me të...

faqe 8-9

LABORATORI QENDROR

Aty ku besueshmëria është në rendin e ditës

faqe 12

KDS

Ceremonia e daljes në pension e Prof. Asc. Dr. Bashkim Elbasani

faqe 14

NJOFTIM

Studimet: Programi në Universitetin Kombëtar të Mbrojtjes, SHBA

faqe 14

QKMBM



Vizioni i Direktivave të Mbrojtjes 2014 nën këndvështrimin e një jete rekreative në FA

Aprovimi së fundi nga znj. Ministre e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, i "Festivalit të Parë të Filmit Dokumentar Ush-tarak" (FFDU) të vendeve të NATO-s, është një aktivitet konkret në zbatim të Direktivave të Mbrojtjes 2014

faqe 13

Rasmussen: Kemi arritur shumë dhe tani kemi nevojë të ruajmë vrullin drejt samitit të Uellsit

Zhvillohet në Bruksel ministeriali i Mbrojtjes së vendeve të NATO-s

Ukraina, Aftësitë Mbrojtëse dhe Afganistani, ishin fokusi i axhendës

Më 26-27 shkurt, u zhvillua në Bruksel Ministeriali i Mbrojtjes ku morën pjesë ministrat e Mbrojtjes së vendeve anëtare të NATO-s, ndër të cilët dhe ministria e Mbrojtjes shqiptare, znj. Mimi Kodheli.

Situata në Ukrainë, aftësitë e mbrojtjes së NATO-s dhe misioni i Afganistanit kryesuan axhendën e takimit dy-ditor së ministrave të Mbrojtjes së NATO-s, i cili nisi më 26 shkurt. Ministri i hapën rrugën samitit të NATO-s, i cili do të zhvillohet në muajin shtator të këtij viti në Uells. Para fillimit të Ministerialit dy-ditor të Mbrojtjes, në lidhje me zhvillimet në Ukrainë, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, i cili kryesoi këtë ministerial, tha: “Ne jemi të inkurajuar se dhuna ka ndaluar me anë të negociatave. Ndërkohë që Ukraina ecën përpara, një dialog gjithëpërfshirës politik, i cili respekton vlerat demokratike, është i rëndësishëm”. Duke theksuar se NATO respekton zgjedhjet sovraane të popullit ukrainas, ai tha, “Ukraina është partnere e NATO-s prej një kohe të gjatë dhe NATO është një mike e sinqertë e Ukrainës. Ne jemi të gatshëm ta ndihmojmë Ukrainën në reformat e saj demokratike”. Për sa i përket Afganistanit, ai u shpreh: “Të gjithë ne i dimë faktet. Nëse Marrëveshja e Sigurisë Dypalëshe ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Afganistanit nuk nënshkruhet, nuk do të ketë Marrëveshje të Statusit të Forcave të NATO-s me Afganistanin. Nëse nuk ka marrëveshje, nuk do të ketë trupa të NATO-s në Afganistan pas vitit 2014. Më lejoni të theksoj: Ky nuk është opsioni ynë i preferuar, por këto janë faktet që duhet të marrim në konsideratë në planifikimin tonë”.

Sesioni i parë i punës u fokusua tek aftësitë mbrojtëse. Ministrat vlerësuan progresin e bërë në fushat kyçe të aftësive, si pjesë e rishqyrtimit të tyre të rregullt si dhe hapat e ardhshëm për të mbushur boshllëqet. Sesioni i dytë u përqendrua në ndërtimin e aftësive mbrojtëse, mënyrave për të zgjeruar mbrojtjen kibernetike dhe sigurinë detare, duke siguruar ndërveprimin e ardhshëm mes aleatëve dhe me partnerët në kuadrin e Iniciativës së Forcave të Ndërlidhura. Gjatë një darke pune, ministri e Mbrojtjes së NATO-s diskutuan në lidhje me zhvillimet e fundit politike në Ukrainë dhe me Afganistanin. Ditën e dytë të këtij ministeriali, ministri e Mbrojtjes u takuan me homologët nga vendet partnere, të cilët kontribujonë në misionin e ISAF-it. Ministrat e Mbrojtjes së NATO-s së bashku me ISAF-in dhe partnerët afganë diskutuan progresin e misionit të ISAF-it dhe planifikimin e një misioni të ri trajnimi, këshillimi dhe ndihme për forcat e sigurisë kombëtare afgane pas vitit 2014. Ministri i Mbrojtjes afgane, Bismullah Khan Muhammadi, përfaqësuesi i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm së OKB-së, Jan Kubis dhe përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Europian për Politikë e Sigurisë e të Punëve të Jashtme, Catherine Ashton, ishin gjithashtu të ftuar. Ministeriali u mbyll me një takim



të Komisionit NATO-Ukrainë. Ukraina ka marrë pjesë në të gjitha operacionet e Aleancës.

Deklaratë e ministrave të Mbrojtjes së NATO-s mbi Ukrainën

Ne vazhdojmë t'i ndjekim shumë afër zhvillimet në Ukrainë. Ne vajojmë humbjen tragjike të jetës. Ne e mirëpresim faktin se dhuna u ndalua me anë të negociatave që shtruan rrugën drejt një rezultati të qetë. Ne theksojmë rëndësinë e një procesi politik gjithëpërfshirës bazuar në vlerat demokratike, respektimin e të drejtave të njeriut, minoriteteve dhe sundimin e ligjit, i cili përmbush aspiratat demokratike të popullit të Ukrainës. NATO dhe Ukraina kanë një partneritet të veçantë, i mishëruar në Komisionin NATO-Ukrainë. Përmes kësaj kornize partneriteti, NATO është e gatshme që të vazhdojë të angazhohet me Ukrainën dhe të ndihmojë në zbatimin e reformave. Reformat e mbrojtjes dhe bashkëpunimi ushtarak mbeten prioritetet kryesore. Ne përgëzojmë Forcat e Armatosura Ukrainase për mosndërhyrjen në krizën politike. Në një demokraci, është e domosdoshme që Forcat e Armatosura të kos ndërhyjnë në procesin politik. Ne theksojmë nevojën për të forcuar kontrollin demokratik mbi sektorin e mbrojtjes dhe të sigurisë, me mbikëqyrje efektive parlamentare dhe përfshirjen e fuqishme të shoqërisë civile. Në kontekstin e ngjarjeve të fundit tragjike, për të ardhmen e Ukrainës janë të nevojshme institucione transparente dhe të përgjegjshme demokratike. Një Ukrainë sovraane, e pavarur dhe e qëndrueshme, vendosmërisht e angazhuar ndaj demokracisë dhe sundimit të ligjit, është çelësi për sigurinë euroatlantike. Në përputhje me Kartën e një Partneriteti të Veçantë ndërmjet NATO-s dhe Ukrainës, aleatët e

NATO-s do të vazhdojnë të mbështesin sovranitetin dhe pavarësinë e Ukrainës, integritetin territorial, zhvillimin demokratik dhe parimin e paprekshmërisë së kufijve, si faktorët kryesorë të stabilitetit e sigurisë në Europën Qendrore dhe Lindore dhe në të gjithë kontinentin si një i tërë.

Ministrat e Mbrojtjes së NATO-s diskutuan trajnimin dhe mënyrat për të përmirësuar aftësitë mbrojtëse

Më 26 shkurt, ministri e Mbrojtjes ranë dakord për të ecur përpara me planet për përmirësimin e një sërë aftësive të mbrojtjes, të cilat janë çelësi për t'u përballur me sfidat e ardhshme të sigurisë. “Nëpërmjet operacioneve tona, duke përfshirë Libinë dhe Afganistanin, ne kemi identifikuar fushat ku aftësitë tona nuk shkojnë aq larg ose shumë pak vende i kanë ato”, tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen. “Operacioni i fundit në Libi, zbuloi mangësitë në municionet e komanduara me precizion, inteligjencën, mbikëqyrjen dhe asetet e zbulimit. Gjithashtu, ka mungesa edhe në ekspertët e trajnuar për të interpretuar të dhënat nga këto asete”, tha Rasmussen. Mbështetja e reformave të sigurisë ndërmjet ndërtimit të kapaciteteve në vendet që kanë nevojë për ndihmë, u diskutua gjatë sesionit të dytë të punës. “Detyra jonë është të sigurohemi që NATO është e mbetet e gatshme dhe në gjendje të përballet me sfidat e së ardhmes dhe ne kemi ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm këtu për ta përgatitur këtë me një panoramë të samitit”, tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s. Ai theksoi se që nga samiti i Lisbonës i vitit 2011, “kemi arritur shumë dhe tani kemi nevojë të ruajmë vrullin drejt samitit të Uellsit dhe më gjerë”.

Ministrat e ISAF-it diskutuan progresin e misionit në Afganistan dhe planifikimin post-2014

Ministrat e Mbrojtjes së NATO-s dhe homologët nga vendet partnere të ISAF-it u takuan me ministrin e Mbrojtjes afgane, Bismullah Khan Mohammadi më 27 shkurt ku rishikuan progresin e misionit të ISAF-it dhe diskutuan marrëdhënien e NATO-s me Afganistanin pas vitit 2014. “Ne jemi fokusuar në përfundimin e ISAF-it, por ne gjithashtu kemi nevojë për siguri dhe parashikueshmëri për të filluar misionin tonë të ri të trajnimit, këshillimit dhe ndihmës së forcave afgane pas vitit 2014”, tha Rasmussen pas takimit. Misioni i ISAF-it do të përfundojë më 31 dhjetor 2014. Në 10 muajt e mbetur, puna e ISAF-it do të fokusohet që forcat afgane të sigurisë të marrin përgjegjësinë e plotë të sigurisë për vendin dhe të ofrojnë mbështetje logjistike për zgjedhjet e këtij viti. “Forcat e sigurisë afgane po krijojnë kushtet për zgjedhje të sigurta. Ato kanë përgjegjësinë kryesore”, tha Sekretari i Përgjithshëm. Misioni i ISAF-it deri më tani ka krijuar mbështetje ajrore për transportin e materialeve zgjedhore për qendrat rajonale dhe vendet e votimit të qarkut. Gjithashtu, ministri diskutuan implikimet dhe rreziqet që rezultojnë nga vonesat në finalizimin e marrëveshjeve të nevojshme ligjore, para se aleatët të mund të krijojnë një mision pasues. Misioni i Mbështetjes së Vendorsur për të trajnuar, këshilluar e ndihmuar forcat e sigurisë afgane pas vitit 2014 kërkon një kuadër ligjor. Nënshkrimi i Marrëveshjes Dypalëshe ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Afganistanit (BSA) është një parakusht për përfundimin e Marrëveshjes së Statusit të Forcave midis NATO-s dhe Afganistanit, e cila aktualisht po negocohet. Rasmussen tha: “Pra, ne sot po diskutojmë nevojën për planifikimin e

të gjithë rezultateve të mundshëm, duke përfshirë edhe mundësinë që mund të mos jemi në gjendje të vendosemi në Afganistan pas vitit 2014, për shkak të vonesave së vazhdueshme që kemi parë. Ky nuk është rezultati që ne duam dhe që është në interes të popullit afgan”. Ministrat në këtë takim u informuan nga përfaqësuesi i Lartë Civil i NATO-s në Afganistan, ambasadori Maurits Jochems dhe nga komandanti i Forcave të Sigurisë Ndërkombëtare, gjenerali Joseph F. Dunford.

Komisioni NATO-Ukrainë theksoi angazhimin e vazhdueshëm

Mbledhja e Komisionit NATO-Ukrainë më 27 shkurt, theksoi angazhimin e anëtarëve të saj ndaj vlerave të demokracisë dhe shtetit ligjor. Takimi ishte një mundësi në kohë reale për aleatët, të cilët diskutuan rreth ngjarjeve të rëndësishme në Ukrainë. “NATO ka një partneritet prej një kohe të gjatë me Ukrainën. Sot, bëmë të qartë se NATO është e gatshme të mbështesë zhvillimin demokratik, reformat e mbrojtjes, bashkëpunimin ushtarak dhe kontrollin demokratik mbi sektorin e sigurisë. Ne dëshirojmë ta vazhdojmë angazhimin tonë dhe konfirmojmë mbështetjen tonë ndaj Ukrainës në rrugën e reformave demokratike dhe gjithëpërfshirëse”, tha Rasmussen. Sekretari i Përgjithshëm theksoi reformën e mbrojtjes dhe bashkëpunimin ushtarak si prioritetet kryesore, duke ofruar mbështetjen e vazhdueshme të NATO-s ndaj Ukrainës, ndërkohë që ajo forcon kontrollin demokratik mbi sektorin e mbrojtjes. Rasmussen shprehu shqetësim mbi zhvillimet e fundit në rajonin e Krimesë në Ukrainë. “Veprimi i këtij mëngjesi, nga një grup i armatosur, është i rrezikshëm dhe i papërgjegjshëm. I bëj thirrje Rusisë të mos ndërmarrë ndonjë veprim që mund të përshkallëzojë tensionin apo të krijojë keqkuptim. I bëj thirrje udhëheqjes së re ukrainase të vazhdojë përpjekjet e saj për të krijuar një proces gjithëpërfshirës politik që reflekton aspiratat demokratike të së gjithë popullit ukrainas si dhe i bëj thirrje të gjitha palëve që të heqin dorë nga konfrontimi e veprimet provokuese dhe t'i rikthehen rrugës së dialogut. Duhet që të gjithë të mbajnë një qëndrim të përgjegjshëm dhe të punojnë për stabilitet”, tha ai. Delegacioni ukrainas në takimin e Këshillit NATO-Ukrainë (NUC), u kryesua nga zëvendësministri i Mbrojtjes ukrainase, Oleksandr Oliynyk. NUC u themelua në vitin 1997 dhe ofron një forum për konsultime ndërmjet aleatëve dhe Ukrainës në çështjet e sigurisë me interes të përbashkët.

Alba Musaraj
Burimi: nato.int

Gjeneralmajor Bazo viziton Komandën e FT të NATO-s në Izmir

Me ftesë të komandantit të Komandës së Forcës Tokësore të NATO, gjenerallejtënant Frederick Ben Hodges, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, në datën 26 shkurt 2014, zhvilloi një vizitë në selinë e kësaj komande, në Izmir të Turqisë. Gjatë takimit u vlerësua bashkëpunimi i deritanishëm ndërmjet Komandës së FT të Aleancës dhe FARSH, sidomos në mbështetjen e ofruar si pjesë e realizimit të prioritetëve kryesore për procesin e certifikimit dhe vlerësimit të reparteve të deklaruara si të dislokueshme në NATO. Gjeneral Bazo theksoi rëndësinë e vijimësisë së këtij bashkëpunimi, si dhe eksplorimin e mundësive të ofruara nga programi i trajnimit, stërvitjeve dhe vlerësimit të kësaj komande. Më pas u vijua me prezantime nga përfaqësues të kësaj komande, në lidhje me vizionin, misionin, rolin, detyrat kryesore dhe kapacitetet që ofron komanda me strukturat e vartësisë, trajnimet dhe stërvitjet si dhe procesin e certifikimit dhe vlerësimit të njësive të deklaruara. Prezantimet u pasuan nga një sesion pyetjesh e përgjigjesh, ku të pranishmit shfaqën dhe interes të veçantë në kapacitetet dhe aftësitë që mundëson Shqipëria në Aleancë. Takimet në qendrën operationale të kësaj komande përmbyllën vizitën e SHSHPFA, gjeneralmajor

Jeronim Bazo në Komandën e FT të NATO në Izmir. Gjatë kësaj vizite gjeneral Bazo u njoh nga afër me misionin dhe detyrat që realizon kjo komandë e rëndësishme e Aleancës Euroatlantike dhe diskutoi me drejtuesit më të lartë të saj për eksplorimin e fushave të reja të bashkëpunimit. Komanda e Forcës Tokësore të Aleancës u formua më 1 dhjetor 2012, me vend-dislokim të përhershëm në Izmir, Turqi. Krijimi i kësaj komande ishte në zbatim të Konceptit Strategjik dhe strukturës së re komanduese të NATO-s, e cila zëvendësoi dy komandat e forcës të NATO-s, Heidelberg, Gjermani dhe Madrid, Spanjë. Komanda e Forcës Tokësore të NATO, mbështetur në misionin e saj, siguron ekspertizë për forcat tokësore të aleancës në drejtim të gatishmërisë, aftësive operationale dhe standardizimit, përfshirë vlerësimin dhe certifikimin. Që prej krijimit të kësaj komande, FARSH ka pasur një bashkëpunim të ngushtë sidomos në drejtim të vlerësimit dhe certifikimit dhe procesit të integritetit të plotë në NATO. Kjo komandë do të drejtojë vlerësimin e reparteve tona të deklaruara në NATO "Pool of Forces" për 2014 e në vijim, ku prioritet do të jetë certifikimi i kompanisë së këmbësorisë, të deklaruara në Forcën e Reagimit të NATO (NRF).



Ministrja Kodheli drejton Ministerialin e Mbrojtjes SHBA-Karta e Adriatikut (A5) në Bruksel

Shqipëria në krye të A5: Prioritetet e NATO-s për rajonin

Në kuadër të pjesëmarrjes në takimin e ministrave të Mbrojtjes së NATO, që u organizua në Bruksel në datat 26-27 shkurt 2014, ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, mori pjesë edhe në Ministerialin e SHBA-Karta e Adriatikut (A-5). Ky ministerial u drejtua nga znj. Kodheli, pasi vendi ynë ka marrë Presidencën e kësaj Iniciative për vitin 2014. Në fjalën e saj të hapjes, ministrja e Mbrojtjes Kodheli shprehu kënaqësinë për pjesëmarrjen e të gjithë ministrave të Mbrojtjes të vendeve anëtare të Kartës së Adriatikut, si dhe për organizimin e këtij takimi në Selinë e NATO-s, e cila mbart një simbolikë të veçantë, që lidhet ngushtë me një ndër parimet themelore të Iniciativës së A-5: integrimi euroatlantik i vendeve të rajonit. Gjatë fjalës së saj, ministrja e Mbrojtjes Kodheli renditi prioritet që do të ketë iniciativa SHBA-Karta e Adriatikut gjatë kryesimit nga vendi ynë, duke theksuar forcimin i bashkëpunimit rajonal për t'iu përgjigjur më mirë nevojave dhe objektivave kombëtare të vendeve anëtare; mbështetjen e politikës së NATO së "Dyerve të Hapura" për anëtarësimin e vendeve të tjera të rajonit; angazhimin e mundshëm në Afganistan pas vitit 2014 në operatione të drejtuara nga NATO; promovimin e Qendrave Rajonale të Trajnimit, etj. Ministrja e Mbrojtjes Kodheli gjithashtu u shpreh se, "Forcat e Armatosura shqiptare prej një kohe të gjatë janë angazhuar dhe do të vazhdojnë angazhimin e tyre në operatione të drejtuara nga NATO". Në vijim të fjalës së saj, znj. Kodheli ka theksuar se, "bashkëpunimi rajonal duhet të orientohet në konceptin e "Smart Defence", si dhe në përdorimin e aseteve të përbashkëta të mbrojtjes në rast emergjencash". Ministrja Kodheli i cilësoi stërvitjet e përbashkëta si një mjet i mirë për të rritur e forcuar më tej bashkëpunimin ushtarak në rajon e më gjerë, duke përmendur sidomos stërvitjen e përbashkët që do të organizohet në vendin tonë në vitin 2015. Ministrat e Mbrojtjes konfirmuan dhe njëherë rëndësinë e procesit të integritetit euroatlantik për forcimin e stabilitetit dhe sigurisë në vendet e Europës Juglindore. Në këtë takim një rëndësi të veçantë iu kushtua rolit të Shqipërisë, Kroacisë dhe SHBA, si vende anëtare të NATO, në mbështetjen



që po i japin vendeve të tjera pjesëmarrëse në këtë iniciativë në procesin e integritetit në NATO apo struktura të tjera rajonale. Pas përfundimit të takimit të Kartës së Adriatikut (A5), që u zhvillua në kuadër të Ministerialit të Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO, në Bruksel, ministrja e Mbrojtjes Kodheli duke iu përgjigjur interesimit të gazetarëve lidhur me këtë takim ka deklaruar se, "Shqipëria ka kryesinë e Kartës së Adriatikut dhe është

e rëndësishme të ndajë me publikun shqiptar katër momente: mbështetjen e politikës së dyerve të hapura që Shqipëria ka në raport me fqinjët apo me të gjithë ata që aderojnë të bëhen nesër vende anëtare të NATO; bashkëpunimin më të ngushtë që ne duhet të kemi për emergjencat civile, i cili padyshim mbas këtij takimi ngrihet në një nivel më intensiv dhe më të lartë; ndihma që Shqipëria duhet t'i japë vendeve fqinjë për rritjen

e mbështetjes dhe transformimit që këto vende duhet të kenë në rrugën e tyre relativisht të gjatë për në NATO, por jo të pamundur, absolutisht jo dhe ajo çka është më e rëndësishme, rritja e kapaciteteve operuese, e cila do të mundësojë bashkëpunimin midis operationeve që forcat e NATO-s udhëheqin me Forcat e Armatosura të Malit të Zi, Maqedonisë, Bosnje-Hercegovinës, Kroacisë dhe Shqipërisë, si pjesë të A5."

Ministrja Kodheli ndjek nga afër aksionin e FA për pastrimin e territorit



Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli e shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, ditën e shtunë, në datë 22 shkurt 2014, ka ndjekur nga afër fazën e tretë të aksionit të pastrimit të territorit nga mbetjet. Ata janë ndalur në pikën doganore të Kapshticës ku forcat të shumta të ushtrisë ishin të angazhuara në pastrimin e territorit. Më tej janë ndalur në të gjitha akset rrugore nga Kapshtica deri në Tiranë ku kanë parë nga afër punën e FA për pastrimin e mbetjeve. Në fjalën e saj ministrja Kodheli u shpreh: "Sot është faza e tretë e një beteje me papastërtinë. Siç e shikoni, si në Morinë ashtu edhe në Kapshticë pamja që shikojmë nuk është aspak dinjitoze". Në vijim të fjalës së saj ministrja Kodheli ka theksuar se duhet një bashkëpunim mjaft i ngushtë me qytetarët, pushtetin lokal dhe biznesin për pastrimin dhe mbajtjen pastër të territorit. Ministrja Kodheli ka falënderuar të gjithë efektivet e Forcave të Armatosura që janë angazhuar në këtë aksion dhe ka vlerësuar maksimalisht sakrificën dhe shembullin e mirë që ato po japin. "Qortim për të gjithë ata

që e konsiderojnë mjedisin një gjë të huaj"- u shpreh në përfundim të fjalës së saj ministrja Kodheli. I pranishëm në aksionin e pastrimit ishte edhe ministri i Mjedisit z. Lefter Koka. Gjatë fjalës së tij ministri Koka ka falënderuar Forcat e Armatosura për punën kolosale që kanë bërë dhe u ka bërë thirrje qytetarëve dhe komunitetit të tregohen më të kujdesshëm dhe ta mbajnë të pastër ambientin në të cilin jetojnë. Gjatë aksionit pastrimit Forcat e Armatosura kanë gjetur pranë Vorës edhe 3 predha artilerie të kalibrit 85 mm. Gjatë fazës së tretë të aksionit të pastrimit u angazhuan 1300 efektivë të Forcave të Armatosura dhe 86 mjete. "Aksioni përfshiu pastrimin e akseve rrugore: Aeroporti "Nënë Tereza"- kryqëzimi i Fushë Krujës (10 km); Aksi rrugor Vorë-Porti Durrës (të dy krahët e autostradës, 42 km); Aksi rrugor Elbasan-Përrenjas (47 km); Aksi rrugor Pogradec-Korçë (5 km në Qafë Pllaçë); Qafë Thanë-Rrajcë (9 km) dhe Korçë-Kapshticë (30 km). Në total gjatë ditës së sotme janë pastruar 143 km rrugë kombëtare dhe mbetjet e mbledhura janë transportuar me mjete të FA për në vendgrumbullimet e tyre.

NATO garanton ndihmë për nevojat e Mbrojtjes që ka Shqipëria

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli mori pjesë në Ministerialin e Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO që u zhvillua në Bruksel në datat 26-27 shkurt 2014. Në këtë ministerial u diskutuan çështje të rëndësishme të lidhura me zhvillimet në NATO. Ndër të tjera, ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, pati një takim me znj. Francesca Tardioli, zëvendësasistente e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s. Gjatë bisedës tejte të ngrohtë, ministrja Kodheli e njohu znj. Tardioli me zhvillimet më të fundit në Shqipëri, si dhe u ndal veçanërisht tek reformat që janë të nevojshme të ndërmerren në fushën e Mbrojtjes. Duke folur për emergjencat civile apo katastrofat natyrore, znj. Kodheli kërkoi mbështetje për përballimin e tyre. Nga ana e saj, znj. Tardioli kërkoi një vlerësim paraprak për nevojat që ka Shqipëria dhe garantoi ndihmë nga NATO. Në këtë kuadër, ministrja Kodheli i bëri me dije znj. Tardioli angazhimin e qeverisë shqiptare në luftën kundër korrupsionit. Një tjetër çështje në të cilën u ndalën bashkëbisedueset ishte edhe situata politike në Itali. Znj. Tardioli tha se qeveria e re italiane ka një program ambicioz, si reforma elektorale, institucionale apo shmangia e burokracive. Në këtë pikë ajo vlerësoi fort rolin e presidentit italian z. Giorgio Napolitano në zgjidhjen e krizës.

Gjimnazi i Baldushkut merr emrin "Feti Vogli"

Gjimnazi i Baldushkut tani e tutje do të quhet gjimnazi Feti Vogli", në nder të Dëshmorit të Atdheut, kapiten Feti Vogli. Në ceremoninë përkujtimore të zhvilluar me këtë rast, në datën 25 shkurt 2014, merrnin pjesë presidenti i Republikës, z. Bujar Nishani, zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor Viktor Berdo, zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Dritan Hila, zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore kolonel Dilaver Hoxha, ushtarak të batalionit të Forcave Speciale, familjarë, miq dhe të afërm të Dëshmorit të Atdheut Feti Vogli. Në nderim të 2-vjetorit të rënies në krye të detyrës të kapiten Feti Vogli, gjatë misionit "Eagle-4" në Kandahar, Afganistan, disa ditë më parë në batalionin e Forcave Speciale u zhvilluan homazhe dhe u vendosën kurora me lule pranë bustit të tij.

Ministrja Mimi Kodheli merr pjesë në Konferencën Rajonale Karta e Adriatikut

“Shqipëria i kushton rëndësi të veçantë bashkëpunimit rajonal, si një shtyllë kryesore e Mbrotjtjes”

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, në datën 24 shkurt 2014, mori pjesë në Konferencën me temë: “Forcimi i bashkëpunimit ndërparlamentar si një garanci për suksesin e Kartës së Adriatikut-SHBA”. Kjo Konferencë u organizua nga Kuvendi i Shqipërisë dhe me pjesëmarrjen e delegacioneve nga vendet e rajonit: Bosnje dhe Hercegovinë, Kroacia, Serbia, Mali i Zi, Maqedonia, Kosova dhe Shqipëria Civile. Të pranishëm në nisjen e punimeve të kësaj Konference ishin: kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Ilir Meta, ministri i Punëve të Jashtme, z. Ditmir Bushati, ambasadori i SHBA, në Tiranë, z. Alexander Arvizu, kryetari i Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare, z. Spartak Braho si dhe mjaft të ftuar të tjerë. Më poshtë jepet fjala e plotë që ajo mbajti në këtë konferencë.

Jam e kënaqur që bashkohem me ju këtë mëngjes dhe që adresoj këtë audiencë të madhe. Në fillim, do të doja t’ju falënderoj ju z. kryetar për organizimin e një aktiviteti të tillë, i cili mbledh anëtarë të shquar të parlamenteve të vendeve fqinje. Thujse 11 vjet më parë, më datë 2 maj 2003, si ministër i Punëve të Jashtme, patët shansin dhe privilegjin të nënshkruani anëtarësimin e Shqipërisë në Kartën e Adriatikut, së bashku me SHBA, Kroacinë dhe Maqedoninë, duke deklaruar kështu përkushtim dhe angazhimin tonë të palëkundur për një grup vlerash të përbashkëta të demokracisë liberale, sundimit të ligjit, respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Përveç bashkëpunimit dhe kontributit rajonal për sigurinë individuale dhe rajonale, ky proces politik siguroi një aleancë me SHBA, gjatë procesit të anëtarësimit në NATO. Sot, për coincidencë, në detyrën tuaj si kryetar i Parlamentit, keni arritur të mbledhni parlamentare nga Bosnje dhe Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Serbia, Maqedonia, Kosova dhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe të shkëmbeni pikëpamje për Kartën e Adriatikut-SHBA, por në këndvështrimin e bashkëpunimit ndërparlamentar. Urime për këtë iniciativë! Do të doja të nënvizoja se ideja e themelimit të Kartës së Adriatikut, në veçanti për demokraci të reja si vendet tona, përfaqëson njëkohësisht një objektiv politik, siç përmenda më lart, por edhe një mekanizëm për të ndihmuar vendet tona drejt integritetit Euroatlantik dhe drejt transformimit të institucioneve tona të sigurisë përmes bashkëpunimit. Me “zgjerimin” e saj në dhjetor të vitit 2008 duke përfshirë Bosnje dhe Hercegovinën dhe Malin e Zi, (secili prej nesh në këtë sallë e pëlqen fjalën zgjerim, në një mënyrë ose në një tjetër) Karta e Adriatikut-SHBA, ose A-5, ka kontribuar vazhdimisht për ndryshimet e mëtejshme substanciale në rajonin tonë, duke i bërë vendet tona më të sigurta se kurrë ndonjëherë. Këtë vit, Shqipëria ka marrë kryesimin e A-5 dhe së bashku me Ministrinë e Punëve të Jashtme po punojmë për të paraqitur një axhendë ambicioze dhe për të siguruar zbatimin e saj me sukses. Ky takim i parlamentarëve vjen si një prolog i kryesisë sonë, i cili



do të ndiqet nga një takim i ministrave të Mbrojtjes të A-5 ditën e enjte, këtë javë, në selinë e NATO në Bruksel. Ndryshe nga dy dekada më parë, sot kemi një arkitekturë të plotë të bashkëpunimit rajonal, e cila, përtej çdo dyshimi, ka ndihmuar në krijimin e stabilitetit politik, ka ofruar më shumë siguri dhe më shumë ndërveprim ekonomik mes vendeve tona. Si vende të të njëjtit rajon, kemi përgjegjësitë përkundrejt njëri-tjetrit, ashtu siç kemi sfidat e përbashkëta në fushën e sigurisë, si krimi i organizuar, korrupsioni, administrimi i kufirit, zgjidhja e të cilave kërkon veprim të përbashkët, duke ndjekur rrugën e bashkëpunimit dhe një qasje rajonale. Për të bërë këtë, kemi pasur mbështetjen e vazhdueshme të organizatave ndërkombëtare, veçanërisht të NATO dhe BE. Këto dy organizma kanë vendosur bashkëpunimin rajonal dhe politikën e fqinjësisë së mirë si një komponent të rëndësishëm të procesit të para anëtarësimit. Si ministër i Mbrojtjes, ndjehem veçanërisht e lumtur me rolin gjithnjë e në rritje të parlamenteve kombëtare për çështje që i përkasin bashkëpunimit rajonal, në përgjithësi, dhe iniciativës së Kartës së Adriatikut-SHBA. Është mjaft inkurajues fakti se klima mjaft pozitive e bashkëpunimit, qoftë kjo në diplomaci, në fushën e mbrojtjes, të sigurisë, ekonomisë, etj, reflektohet gjithashtu në të njëjtin nivel nga bashkëpunimi i parlamentarëve kombëtarë. Ky takim është një demonstrim domethënës i këtij bashkëpunimi. Nga një këndvështrim tjetër, kur është fjala për bashkëpunim rajonal, por jo vetëm, është gjithashtu e rëndësishme që ministrinë e qeverisë, agjencitë e zbatimit të ligjit, ekzekutivi në përgjithësi, të krijojnë një marrëdhënie efikase me Parlamentin, i cili do të rezultonte në një bashkëveprim intensiv mes të dy palëve dhe në një rol aktiv të komisioneve parlamentare, duke lejuar kështu këtë të fundit të ushtrojë funksionet e tij mbikëqyrëse të përcaktuara me ligj. Jo gjithmonë ka qenë kështu. Unë e konsideroj këtë një sfidë reale për maxhorancën e re. Vendimi ynë për të ndarë mandatin e një deputeti nga ajo e një ministri të qeverisë, është një hap në drejtimin e duhur. Kjo gjë, ndjekur nga ndryshime të tjera të kuadrin ligjor,

do të nxiste mbikëqyrje parlamentare më demokratike mbi ekzekutivin. Duke u rikthyer sërish tek bashkëpunimi rajonal, tek marrëdhëniet në fushën e mbrojtjes, unë e konsideroj bashkëveprimin me Parlamentin dhe komisionin përkatës parlamentar si shumë të rëndësishëm. Zbatimi i duhur i kësaj politike kërkon një rol më të fortë të Parlamentit në miratimin e ligjeve të kërkuara në fushën e Mbrojtjes, miratimin e buxhetit të kërkuar për Forcat e Armatosura për të përmbushur mis-

ionin e tyre kushtetues dhe detyrimet ndërkombëtare, sa për të përmendur vetëm dy fushat më të rëndësishme. Në përfundim të fjalës sime, dua të theksoj se Shqipëria i kushton rëndësi të veçantë bashkëpunimit rajonal. Nga këndvështrimi i Mbrojtjes, ne e shohim atë si një prej shtyllave tona kryesore të politikës së Mbrojtjes. Vendet të tjera, për këtë jam e sigurt, bëjnë të njëjtën gjë. Bashkëpunimi rajonal është padyshim një kuadër politik që ka ndikuar pozitivisht tek politikat në

rajon gjatë viteve të fundit dhe shpresojmë që do të justifikojnë akoma dhe më shumë ekzistencë e tij në vitet që do të vijnë. Sfida jonë kryesore e të ardhmes mbetet ndërtimi i një bashkëpunimi të qëndrueshëm rajonal që përfshin dimensionin politik, rritjen ekonomike dhe sigurinë, të cilat do të nxisin avancimin e mëtejshëm të vendeve të rajonit drejt NATO dhe BE. Faleminderit z. kryetar që bëtë të mundur realizimin e kësaj konference. Jam e bindur se kjo konferencë do të nxisë më tej bashkëpunimin ndërparlamentar.

Forcimi i bashkëpunimit ndërparlamentar si garanci e suksesit të Kartës së Adriatikut-SHBA

Nën kujdesin e Kuvendit të Shqipërisë ka zhvilluar punimet, në datën 24 shkurt 2014, “Konferenca e Komisioneve të Sigurisë të Parlamenteve të Kartës së Adriatikut A5” me temën “Forcimi i bashkëpunimit ndërparlamentar, garanci e suksesit të Kartës së Adriatikut-SHBA”. Të pranishëm në konferencë ishin Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta, Kryetari i Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare, z. Spartak Braho, Ministri i Punëve të Jashtme, z. Ditmir Bushati, Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli dhe Ambasadori i SHBA-së, z. Aleksandër Arvizu. Gjithashtu, në këtë aktivitet morën pjesë edhe përfaqësues të Komisioneve të Sigurisë Parlamentare të vendeve të Kartës së Adriatikut nga Shqipëria, Bosnja, Kroacia, Serbia, Mal i Zi, Maqedonia, Kosova si edhe nga Shqipëria Civile. Në fjalën e hapjes, Kryetari i Komisionit të Sigurisë Kombëtare, z. Spartak Braho, e cilësoi nismën mbarë-ballkanike të Kartës së Adriatikut, një histori suksesi, e cila bëri të mundur anëtarësimin e suksesshëm të Shqipërisë dhe Kroacisë në NATO. “Në gjykimin tonë vazhdimi i Bashkëpunimit në kuadrin e Kartës së Adriatikut do të promovojë dhe fuqizojë në radhë të parë bashkëpunimin rajonal dhe sigurinë, si dhe do të rrisë ndërveprimin në adoptimin e standardeve që kërkojnë

si nëpërmjet stërvitjeve të përbashkëta ashtu edhe në vazhdimin dhe thellimin e reformave demokratike, respektimin e të drejtave të njeriut, të minoriteteve, impenjim në luftën kundër terrorizmit, trafikut ndërkufitar, etj”, theksoi Braho. Kryetari i Komisionit të Sigurisë Kombëtare vlerësoi rolin e pazëvendësueshëm të SHBA-ve, falë të cilës Karta vazhdon të kontribuojë në mënyrë aktive për t’i sjellë vendet e rajonit më pranë integritetit të plotë euro-atlantik. “Duhet të vlerësohet roli i pazëvendësueshëm i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, falë të cilës Karta vazhdon të kontribuojë në mënyrë aktive për t’i sjellë vendet e rajonit më pranë integritetit të plotë euro-atlantik, shtoi z. Braho. Ne mbështesim dhe inkurajojmë progresin e bërë nga vendet aspirante të rajonit tonë, para ministerialit të qershorit. Ndaj, mendoj se është e rëndësishme, që vendet aspirante, të paraqesin rezultate pozitive brenda qershorit, në mënyrë që vendet aleate që mbështesin idenë e zgjerimit të Aleancës”, theksoi ai. Ndërsa, Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta në fjalën e tij ka vlerësuar kontributin dhe përkushtimin e secilit vend anëtar të Kartës përmes angazhimit respektiv në funksion të rritjes së sigurisë në rajonin tonë, si dhe për dedikimin ndaj avancimit të axhendës së përbashkët të integritetit Euro-Atlantik. Gjithashtu, z. Meta ka shprehur mirënjohjen e Kuvendit të Shqipërisë për mbështetjen e vazhdueshme të fuqishme të SHBA për

Kartën e Adriatikut dhe për promovimin e integritetit Euro-Atlantik të së gjithë vendeve të Ballkanit Perëndimor. “Pa një Ballkan Perëndimor të integruar plotësisht në strukturat Euro-Atlantike, parametrat e sigurisë në Evropën Juglindore nuk do të arrijnë kurrë standardet që ne dëshirojmë dhe që qytetarët tanë meritojnë. Nga ana tjetër, as vetë Bashkimi Evropian nuk do të jetë kurrë i plotësuar dhe i sigurt, tha z. Meta. “Shqipëria i mbështet plotësisht aspiratat e të gjitha vendeve të rajonit tonë për anëtarësim në NATO dhe në Bashkimin Evropian, sepse jemi të bindur se avancimi i këtyre proceseve të ndërlydhura, do të sjellë më tepër siguri, paqe afatgjatë dhe më tepër prosperitet, duke na çuar të gjithëve më afër standardeve të politikë-bërjes dhe të jetesës së Bashkimit Evropian”, theksoi Kryetari i Kuvendit. Sipas z. Meta roli i NATO-s në mbarëvajtjen e paqes në Ballkan është i padiskutueshëm, por bashkëpunimi rajonal, duhet të prodhojë efekte konkrete për rritjen e prosperitetit ekonomik të së gjithë qytetarëve tanë. “Kjo mund të ndodhë vetëm nëse zhvillimi ekonomik shoqërohet nga forcimi i institucioneve demokratike, që mund të ndodhë vetëm përmes integritetit të plotë të secilit vend të Ballkanit në NATO dhe në Bashkimin Evropian. BE është destinacioni ynë i përbashkët, pavarësisht progresit të secilit vend. Vetëm nëse familja e madhe evropiane plotësohet me pjesën e saj të munguar të Ballkanit Perëndimor, do të

Fjala e zëvendësshefit të SHPFA, gjeneralmajor Viktor Berdo

Siguria më e mirë është siguria që ndërtohet së bashku

Konferenca “Karta e Adriatikut - Forcimi i bashkëpunimit ndërparlamentar si garanci e suksesit të Kartës së Adriatikut - SHBA”

Faleminderit për ftesën, për të qenë pjesëmarrës në këtë konferencë të bashkëpunimit ndër-parlamentar në kuadrin e Kartës së Adriatikut – SHBA. Që në fillim të kësaj fjale do të theksoja që një rajon i sigurt, në paqe dhe i integruar, përbën vizionin dhe synimin tonë të përbashkët. Karta e Adriatikut, e cila startoi si një iniciativë për të promovuar një formë të re të bashkëpunimit ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor, është një projekt aspirues me synim, integrimin e plotë në organizmat politik, ekonomik, të sigurisë dhe mbrojtjes evropiane dhe trans-atlantike. Ajo erdhi për t'u bërë pjesë e projektit të vazhdimësisë së politikës së “Dyerve të Hapura të NATO-s”, si dhe e sigurimit të bazave të bashkëpunimit dhe mbështetjes reciproke të vendeve candidate. Kjo Kartë, fillimisht ofroi në një bashkëpunim partneriteti Shqipërinë, Kroacinë dhe Maqedoninë (Maj 2003) dhe më pas (Dhjetor 2008), dy vende të tjera Mali i Zi dhe Bosnjë-Hercegovina, iu bashkuan zyrtarisht kësaj iniciative, dhe vendosën të ndjekin të njëjtën rrugë të suksesshme të tre vendeve të para, për arsye të aspiratës së përbashkët, anëtarësimit e tyre në NATO. Karta e Partneritetit “Adriatik A-5”, (US- Adriatic Charter) është faktuar në vazhdimësi, si model i një vizioni dhe vullneti të bashkëpunimit të përbashkët rajonal, që i shërben forcimit të frymës së besimit reciprok dhe të sigurisë, për realizimin e aspiratës euro-atlantike. Ky bashkëpunim është realizuar me programe specifike në fushën e mbrojtjes. Këto programe kanë mishëruar vizionin dhe vullnetin e anëtarëve të këtij organizmi, si dhe kanë përfshirë në mënyrë të detajuar aktivitete të fushës së mbrojtjes dhe sigurisë me interesa të përbashkëta për rajonin. Këto programe kanë konsistuar në: takime vjetore të Ministrave të Mbrojtjes; takime të Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të FA; realizimin e projekteve dhe veprimtarive të përbashkëta, në kuadër të MAP/PfP, shkëmbime



informacioni; kontribute në kuadrin e SEBRIG; Workshop-e në fushën e logjistikës; zhvillimin e marrëdhënieve për binjakëzimin dhe familjarizimin e njësive të deklaruara në NATO, si dhe vlerësim të njësive në stërvitje të përbashkëta apo në fushën arsimimit dhe trajnimeve. Programet vjetore të bashkëpunimit ndërmjet

vendeve të Kartës së Adriatikut kanë patur një tendencë e dinamikë zgjerimi dhe janë performuar në mënyrë cilësore. Tendenca e një bashkëpunimi në rritje, ka sjellë si leadershipin politiko-ushtarak, ashtu dhe strukturat ushtarake të vendeve anëtare të këtij organizmi, në konferenca, takime dhe në aktivitete të ndryshme. Në kuadër

të këtij bashkëpunimi, janë zhvilluar e realizuar projekte dhe veprimtari si të karakterit stërvitor dhe trajnues, ashtu dhe kryerja e misioneve të përbashkëta. Është realizuar përgatitja dhe pjesëmarrja me një ekip të përbashkët mjekësor, në kuadër të misionit ISAF të NATO-s, në Afganistan. Janë zhvilluar disa stërvitje të përbashkëta dhe me përfitim përvoja si: Adriatik Phiblex, Eagle SAR, Adriatik Eagle, dhe Joint Reaction-13, apo konferenca të ndryshme për trupën e n/ oficerit etj. Gjithashtu, veprimtari të tjera të spikatura të këtij bashkëpunimi rajonal janë: pjesëmarrja e ushtarakeve të këtyre vendeve në “Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes” në Akademinë e Mbrojtjes të FA të RSH në Tiranë; shkëmbimi i lektorëve të këtyre vendeve, si dhe hapja e “Qendrës Rajonale për Marrëdhëniet me Publikun dhe Trajnimin” në Maqedoni. Në kuadër të kornizës A-5, Shqipëria është e angazhuar në projektin e inicuar nga Kroacia, duke mbështetur me ekupe trajnimi policor (POMLT), Policisë Afgane. Në Konferencën e 17-të “Kartës së Adriatikut”, nga vendet pjesëmarrëse është konfirmuar forcimi i lidhjeve të bashkëpunimit brenda Formatit A-5, me qëllim hartimin dhe zbatimin e projekteve konkrete në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, duke i vlerësuar të suksesshme rezultatet e deritanishme të bashkëpunimit. Njëkohësisht vendet e Formatit A-5 kanë konfirmuar vullnetin e tyre për angazhimin dhe mbështetjen e mëtejshme me instruktorë trajnimi, Shkollën e PU Afgane, angazhim i cili do të vazhdojë edhe në të ardhmen, në kuadrin e “Resolute Support Mission” në Afganistan. Konferencat, takimet e nivelit të lartë politiko-ushtarak, veprimtaritë stërvitore, trajnimet, misionet apo projektet e tjera të përbashkëta të zhvilluara në kuadrin e “Kartës së Adriatikut” kanë afirmuar vullnetin për angazhim të përbashkët në forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve midis nënshkruesve të Kartës. Njëkohësisht ato kanë dhënë impakte pozitive në zgjerimin dhe thellimin e fushave të bashkëpunimit nëpërmjet nismave rajonale,

duke garantuar një paqe të qëndrueshme dhe stabilitet rajonal. Vendet pjesëmarrëse të Karts së Adriatikut ndajnë pikëpamje të përbashkëta edhe sa i takon zhvillimit të koncepteve të reja në kuadër të “Pooling and Sharing” rajonal, si dhe për ndërtimin e kapaciteteve të qëndrueshme, në një kohë me burime financiare të kufizuara. Bazuar në detyrat e dala nga Samiti i Çikagos (Maj 2012), në kushtet e kufizimeve financiare të ekonomisë globale, vendet e Rajonit kanë afirmuar zhvillimin e konceptit të “Mbrojtjes së Zgjuar” (Smart Defence). Implementimi i këtij koncepti nga vendet e A-5, konsiston në ndërtimin e kapaciteteve mbrojtëse të përbashkëta për rajonin, dhe për angazhimet në kuadrin e operacioneve të drejtuara nga NATO. Janë për t'u vlerësuar pozitivisht angazhimet e vendeve anëtare të kartës A-5 në zhvillimin e projektit ambicioz të vëzhgimit të hapësirës ajrore në BRAAD - Përafrimi rajonal Ballkanik për Mbrojtjen Ajrore” (Balkan Regional Approach to Air Defense), si një prioritet për të ardhmen. Ky projekt do realizojë shpërndarjen e Kapaciteteve të Mbrojtjes Ajrore për Vendet e Ballkanit, në adoptimin e përafrimin rajonal, duke i kushtuar kujdes të veçantë ndërveprueshmërisë në një shkallë më të lartë midis vendeve pjesëmarrëse dhe NATO-s, dhe duke marrë parasysh shkurtimet domethënëse të kostove të vendeve pjesëmarrëse. Zbatimi i këtij projekti do të sjellë përfitime të mëdha për vendet e Ballkanit, si për sa i përket kostos së blerjes së aseteve, ashtu dhe kostos së mirëmbajtjes së tyre. Njëkohësisht realizimi i këtij projekti, si çdo projekt tjetër i përbashkët, do të rrisë më tej frymën e bashkëpunimit dhe të besimit reciprok. Suksesi i iniciativave të tilla rajonale, i cili realizohet nëpërmjet programeve të bashkëpunimit dhe zgjerimit bën të mundur që i gjithë rajoni i Ballkanit ta ndjejë më afërt integrimin në strukturat euro-atlantike, ku dhe roli i Shqipërisë, si vend anëtar i NATO-s, është i rëndësishëm dhe njëkohësisht në mbështetje të vendeve të tjera pjesëmarrëse në këtë iniciativë. Në këtë këndvështrim, Shqipëria vlerëson si mjaft të rëndësishme Iniciativën e A-5 për proceset integruese, dhe si vend mbështetës i “politikës së dyerve të hapura të NATO-s”, inkurajon pa përjashtim përpjekjet e vendeve të rajonit, në përmbushje të kriterëve për anëtarësim. Dhe për këtë proces, nismat rajonale janë çelësi i suksesit. Vetë “Karta e Adriatikut”, si pjesë e partneritetit dhe ndërtimit të kolacioneve, ndikon drejtpërsëdrejti për krijimin e një mjedisi më të sigurt rajonal, si dhe rritjen e frymës së besimit reciprok. Ajo ndër të tjera, kontribuon në mënyrë thelbësore dhe të drejtpërdrejt edhe në transformimin e suksesshëm të Forcave të Armatosura të gjitha vendeve të Kartës A-5, si dhe shkon në përfitim të vlerave integruese. Në mbyllje do të citoja një thënie të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO zotit Rasmussen i cili thotë se: “Siguria më e mirë është siguria që ndërtohet së bashku”.



arrijmë të përballemi bashkërisht me sfidat që kërcënojnë elementet e sigurisë dhe stabilitetit social jo vetëm në rajon, por në të gjithë kontinentin”, tha ndër të tjerash Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta. Ministria e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli duke marrë fjalën gjatë konferencës deklaroi se Karta e Adriatikut ka ndikuar në ndryshimet thelbësore në vendin tonë dhe ka rritur sigurinë në vendet e rajonit. Znj. Kodheli e cilësoi këtë takim si të veçantë, jo vetëm për integrimin e vendeve të rajonit, por dhe për sigurinë dhe bashkëpunimin e tyre për një të ardhme më të sigurt. “Ky bashkëpunim ka sjellë jo vetëm siguri, por shtimin e anëtarëve të rinj në aleancë. Gjithashtu, këtë vit Shqipëria ka marrë kryesimin e radhës, ndryshe nga dekada më parë, rajoni është me i qetë dhe më

bashkëpunues. Ministria e Mbrojtjes u shpreh se Shqipëria i kushton rëndësi kryesore bashkëpunimit rajonal. “Sfidat tona të ardhshme janë siguria dhe përfshirja e vendeve në një bashkëpunim afatgjatë”, theksoi znj. Mimi Kodheli. Ndërkaq, Ministri i Punëve të Jashtme, z. Ditmir Bushati u shpreh gjatë konferencës se Shqipëria është e vetëdijshme për ndjeshmërinë e çështjes së zgjerimit të Kartës së Adriatikut. Z. Bushati risolli në vëmendje faktin se karta u nënshkrua në 2 maj 2003 në Tiranë për Shqipërinë nga Ministri i Punëve të Jashtme i atëhershëm, z. Ilir Meta. “Nënshkruesi për palën amerikane, Sekretari Powell, në fjalën e tij shpalosi vizionin dhe konfirmoi angazhimin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në sigurimin e paqes dhe stabilitetit në

rajonin e Evropës Juglindore”. “Por më lejoni të theksoj se ne udhëhiqemi nga nevoja për të nxitur më tej marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimit rajonal, që janë parakusht i rëndësishëm për integrimin euro-atlantik, si dhe për paqen dhe stabilitetin në rajon”, tha ai. “Sot 11 vjet pas formimit të Nismës së Kartës së Adriatikut, rajoni është në paqe. Por paqja dhe stabiliteti që gëzojmë aktualisht nuk duhen marrë si të mirëqena, sepse vija të tjera ndarëse rrezikojnë të shfaqen. Duhet shmangur rreziku i grupimit të vendeve të rajonit në vende të dalluara dhe ngelëse në klasë. Pasi, një rajon që nuk është i integruar plotësisht nuk mund të eksportojë siguri”, deklaroi z. Bushati. Në fund e mori fjalën edhe ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, z. Aleksandër Arvizu, i cili ka theksuar vendosmërinë e palëkundur të SHBA-ve për të vijuar politikën e dyerve të hapura të NATO-s. “Rreth 11 vjet më parë, Karta e Adriatikut-SHBA nisi pikërisht këtu në Tiranë. Colin Powell nënshkroi për SHBA-të dhe më vjen mirë që Kryetari i Kuvendit, z. Meta, i cili firmosi për Shqipërinë në cilësinë e Ministrit të Punëve të Jashtme, është këtu sot për të parë se Karta mbetet po aq e rëndësishme edhe sot e kësaj dite, teksa rajoni vazhdon rrugëtimin drejt integritimit Euro-Atlantik”, tha z. Arvizu. Sipas ambasadorit, Karta e Adriatikut kontribuon për një Europë të lirë dhe në paqe. Ripohojmë përkushtimin tonë të përbashkët për të luftuar korrupsionin dhe krimin dhe për të mbrojtur të drejtat njeriut dhe liritë civile për të gjithë individët në rajon. Aleanca mundet dhe duhet të pranojë anëtarë të rinj kur ata të jenë gati”, deklaroi ambasadori z. Arvizu.



Pas përfundimit me sukses të misionit në Kanadamar, Afganistan, më datë 21 shkurt 2014, u kthye në Atdhe kontingjenti "Eagle 7", efektivi i batalionit të Forcave Speciale, strukturë e Forcave Tokësore. Në pritje të kontingjentit merrnin pjesë zëvendësministri i Mbrojtjes, Dritan Hila, zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Viktor Berdo, komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, atasheu i Mbrojtjes së SHBA-së, kapiten i rangut të dytë, Ralph Shield, familjarë e të afërm të misionarëve të paqes. Zëvendësministri i Mbrojtjes, Hila, u uroi mirëseardhjen efektivave të kontingjentit "Eagle 7" dhe i përgëzoi ata për përmbushjen me sukses të misionit, performancën e treguar dhe kthimin shëndoshë e mirë në Atdhe.



Zëvendësministri Hila: "Ju faleminderit që nderuat Shqipërinë dhe FA..."

Kthehet në Atdhe efektivi i kontingjentit "Eagle 7" i Batalionit të Forcave Speciale të Forcave Tokësore

MAJOR NEXHBEDIN BASHA

Jemi krenar për fjalën e mbajtur...

Ishte ora 15:45, datë 21 shkurt 2014. Avioni civil "ATAS AIR", u ul në pistë në afërsi të zonës ushtarake, e cila është në juridiksion të komandës së Forcave Ajrore. Sapo hapet porta, në shkallën e avionit shfaqen uniformat ushtarake, efektiva të kontingjentit "Eagle 7", të Batalionit të Forcave Speciale, me prijësin e tyre, Flamurin Kombëtar. Nënkolonel Kuto Hasani, shef i shtabit të Forcës Ajrore, ndjek me përgjegjësi situatën me qëllim që gjithçka në këtë aeroport të kryhet sipas akteve ligjore. "Ky është detyrim i përhershëm ligjor i Forcave Ajrore, për të organizuar pritjen dhe përcjelljen e kontingjenteve ushtarake të angazhuar në misione të mbështetjes së paqes dhe këtë e realizojmë në koordinim me aviacionin civil "Nënë Tereza", për kryerjen e procedurave, marrjen e masave organizative për pritjen e familjarëve dhe krijimin e ambienteve për kontrollin mjekësor, si dhe akomodimin e përkohshëm të pajisjeve që mbartin me vete", - shprehet Nënkoloneli. Ai na shpjegon se për të realizuar më së miri të gjithë detyrimet kemi bashkëpunuar me komandën e Forcave Tokësore, Policinë Ushtarake dhe Qendrën e Bashkuar Operacionale, bashkëpunim, i cili ka rezultuar i suksesshëm.

Pak minua para se të nis ceremonia e kthimit në Atdhe të kontingjentit "Eagle 7" gjetëm kohë për të biseduar me familjarë të misionarëve, njerëz të së gjitha moshave, fëmijë, djem dhe vajza, burra e gra. Askush prej tyre nuk e fsheh mallin dhe dashurinë për njerëzit e tyre të dashur. Në mes rreshtave kishte shumë fëmijë. Ata ishin përgatitur si për festë. Kish edhe prej atyre që ishin veshur edhe kostum ushtarak, enkas për këtë ditë, për të treguar ndoshta edhe ëndrrën e tyre për të ecur në gjurmët e baballarëve të



tyre. Një familje e tërë kishte zbritur nga Selita, Tiranë, për në Rinas. Halil Kurti, është njëri nga të afërmit e rreshter Allion Moqit. "Pres djalin e kumatit", - thotë ai dhe ndjehet krenar. Vladimiri është 4 vjeç. "Kam dalë të pres babin," - thotë ai, duke treguar se kishte vetëm dy ditë që nuk kishte folur me të, por që i dukej sikur të ishin muaj. "Më ka marrë malli, për babin...", - thotë Vladimiri, nipi i Rruzdiut dhe Hamides, prindërve të Allionit, që së bashku me bashkëshorten e tij Blerinën gjendeshin në Rinas, për të përjetuar këtë emocion mbresëlënës. Pasi marrin lajmin se avioni u ul në pistë sytë e tyre shkëlqyen nga gëzimi. Në këtë aeroport në këtë shesh, ceremoni të tilla, nisje e përcjellje kontingjentesh, janë zhvilluar me dhjetëra e qindra. Secila në vetvete mbart emocione dhe mbresa të shumta, jo vetëm nga familjarë, ushtarakë të FA-së por edhe ministra, deputet, kryeministra, presidentë etj, prezentë në shumë evenimente të FA-së. Koha ecën dhe ambasadorët e paqes zbresin një nga një, duke pasur si prijës të tyre flamurtarët. Janë 50 veta, nënoficerë dhe oficerë. Ndjehen të lumturuar,

ata dhe familjarët, që plotësuan me dinjitet misionin e tyre. Komandanti i kontingjentit major Pali Dakolli, ka çfarë t'i raportojë zëvendësministrit të Mbrojtjes, Dritan Hila, zëvendëshefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Berdo, komandantit të Forcave Tokësore, gjeneralmajor Dushkut, atasheut të Mbrojtjes së SHBA-së, kapitenit të rangut të dytë, Ralph Shield, komandantit të BFS, nënkolonel Qazim Hoxha dhe familjarëve e të afërmeve që kishin dalë në pritje të tyre - një pritje e ngrohtë dhe miqësore. Majori(r), Ylli Tartari, kishte në përbërje të kontingjentit djalin, Erindin, me gradën e togerit, si komandant grupi. Me të ishte edhe daja i djalit, nënkolonel Flamur Hadushi. "Kam vite që kam shërbyer në radhët e FA-së dhe kam përjetuar ngjarje nga më të ndryshmet, por emocionet e ditës së sotme nuk mund t'i fsheh, pasi shoh të realizuar më së miri detyrën nga im bir, Erindi, dhe kthimin e tij shëndoshë e mirë, bashkë me gjithë shokët në Atdhe, duke nderuar veten, familjen, kombin dhe Shqipërinë", - shprehet Ylli. Tek shkëmbejmë ndonjë

opinion me familjarët dhe fëmijët e misionarëve, vërejmë se ata ndjehen të lumturuar pasi e mbajtën amanetin e tyre, - kthimin shëndoshë e mirë dhe me faje të bardhë, në tokën e Arbrit.

"Faleminderit që na nderuat, faleminderit që u kthet shëndoshë e mirë në Atdhe. U jemi mirënjohës për ç'ka ju bëtë për kombin afgan dhe që e nderuat Shqipërinë. Ju faleminderit familjarëve për mbështetjen e dhënë..." - këto ishin fjalët e zemrës që shprehu zëvendësministri i Mbrojtjes, Dritan Hila, tek misionarët, familjarët e të pranishmit në ceremoninë e pritjes së kontingjentit "Eagle 7". Ai vlerësoi performancën e treguar nga personeli i kontingjentit, shumica e të cilëve janë me eksperiencë nga shumë misione, si Irak, Çad dhe Afganistan. Kur pyet familjarët se si janë ndjerë në mungesën gjashtëmujore të njerëzve të tyre të zemrës, disa prej tyre shprehen njëzëri se: "Të themi se jemi ndjerë mirë, gënjejmë veten dhe ju, të themi se nuk kemi komunikuar me ta as këtë nuk na e mban goja pasi kanë qenë mundësitë e komunikimit, si me telefon edhe me "Skype", e kjo, ndoshta na e ka lehtësuar disi

mungesën. Por mbi gjithçka duam të shprehim mirënjohjen tonë autoriteteve eprore, Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, komandës së Forcës Tokësore, komandës së Batalionit të Forcave Speciale, të cilët na janë gjendur pranë në çdo moment, duke na krijuar mundësinë të bëhemi pjesë e gëzimeve në ceremoni festash të organizuara me fëmijët e ushtarakëve në mision..." Nënkolonel Qazim Hoxha, komandant i BFS-së, tha ndër të tjera: "Rruga efektivave të Batalionit Special, e nisur prej shumë vitesh në misione paqeruajtëse e luftarake nuk mbaron këtui. Ajo rrugë vazhdon aktualisht me misionin e kontingjentit "Eagle 8", në Bazën Spin Boldak, Kandahar, Afganistan."

Opinionet janë të shumta. Secili dëshiron të flasë dhe të përcjellë një mesazh që në thelb është mall dhe dashuri, krenari dhe siguri. Altin Llosha, nguron të flasë, pasi siç thotë shprehimisht ai: "Nuk më lejon ligji, nuk duhet të flas pa autorizimin e komandantit". Në të vërtetë, ky ishte edhe mesazhi i përcjellë në letërën qarkore të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, drejtuar komandave, mbi publikimin jashtë rregullave të aktiviteteve, simboleve, uniformës dhe pajisjeve ushtarake nga personeli i FA në rrjetet sociale dhe për rregullat e komunikimit me medien dhe dhënies së informacionit, një shqetësim shumë i drejtë, i cili i ka kaluar kufijtë dhe është bërë prezent edhe tek efektivat që janë në mision, përfshirë këtu edhe personelin e kontingjentit "Eagle 7". Gjithsesi, mundemi të marrim për këtë ngjarje, përshtypje nga dy fëmijët e tij, Hersa e Santinos, të cilët nuk i shqiten nënës së tyre, Aleksandrës: "Jemi shumë të lumtur që baba do të jetë tani me ne! Mezi e kemi pritur këtë moment për të qenë të gjithë bashkë. Ne e duam shumë babin. Ai është hero." Santino, i cili ka dëshirë të bëhet ushtarak si i ati, ka ardhur deri në Rinas ta pres atë "si u ka hije burrave", me uniformë ushtarake dhe me emblemë të Forcave Speciale. Së fundi pas ceremonisë nis dorëzimi



i armatimit dhe pajimeve. Shtabi i Batalionit të Forcave Speciale nën drejtimin e nënkolonelit Artur Loka, sheh me detaje gjithçka që ka të bëjë me masat për dorëzimin e pajimeve dhe armatimeve. Nënkolonel Hajdar Gurra, shefi i logjistikës e garanton shtabin e Forcës, se nga personeli i logjistikës, përfshi edhe ekipin shëndetësor janë marrë të gjitha masat për administrimin e vlerave materiale dhe armatimit dhe pa pasur asnjë problem. Vizita e fundit para se të largohemi nga Aeroporti Ushtarak ishte në një “Qendër Shëndetësore” të improvizuar, për vaksinimin e personelit të kontingjenteve. Si gjithnjë, “veterani” i shëndetësisë, doktor Beqir Guri, është i pranishëm në të gjithë eventet e FA-së, si në pritje edhe në përcjellje të kontingjenteve. Ai dhe kapiten Petro Thanasi, rreshterë Silvana Abedini, personel i SU-së dhe i FT-së si dhe rreshter Beqir Kollçaku, infermier i Batalionit të Forcave Speciale, megjithëse janë marrë seriozisht me vaksinimin e misionarëve, përsëri

kontrollojnë një për një kartelat e secilit, me qëllim që të mos mbetet asnjë individ pa u vaksinuar, - detyrë kjo shumë e rëndësishme pas ardhjes nga misioni. Nëse vitet e tjera, ky shërbim për gjithë kontingjentet kryhej në repartet e tyre, këto vitet e fundit është krijuar një “komoditet” nga Komanda e Forcave Ajrore, duke vënë në dispozicion ambiente të posaçme dhe shefin e Shëndetësisë të kësaj force, majorin Fran Daçi, i cili qëndron së bashku me personelin shëndetësor të Spitalit Ushtarak të Forcave Tokësore deri sa plotësohet detyra për kryerjen e shërbimit shëndetësor. Gjatë procedurave, pranë tyre qëndron psikologjia e Forcës Tokësore, kapitene Blerina Breçani, e cila ndjek situatën dhe interesohet nëpërmjet komandantit të kontingjentit, major Dakollit, mbi gjendjen morale e psikologjike e për trajtimin e personelit të ngarkuar psikologjikisht me ngarkesa stresante. Gjithsesi, testimi psikologjik është detyrë e një faze të mëvonshme. Tashmë, ata janë në shtëpi!

Dita e mjedisit në Forcat Tokësore, nis me projekte të reja dhe konkrete

Batalioni i Poshnjes, mbjell 150 rrënjë ullinj

Sapo futesh në ambientet e garnizonit Poshnje të Batalionit të Tretë të Këmbësorisë, strukture e Forcave Tokësore, ndeshesh me një dekor të veshur me gjelbërim, kurora me peme dekorative, lulishte e kënde çlodhëse, të gjitha të krijuar nga dora e qindra efektivave ushtarakë dhe civilë që kanë shërbyer dhe shërbejnë në strukturat e këtij batalioni. Një herë në muaj, dita e martë e dytë e çdo muaj është shpallur “Dita e Mjedisit”, ku efektivat ndërpresin çdo lloj aktiviteti stërvitor dhe merren vetëm me përmirësimin e mjedisit si brenda territorit në garnizone, po ashtu edhe në afërsi të rrethinave ku ka komunitet. Për këtë në Batalionit e Tretë të Këmbësorisë janë ngritur dhe funksionojnë grupe pune me përfaqësues nga seksionet në shtab, të cilët monitorojnë dhe planëzojnë zhvillimin sa më me efikasitet të punës për përmirësimin e mjedisit. 11 Shkurti 2014, ka qenë “Dita e Mjedisit” e Forcave Tokësore, ku efektivat e garnizonit “Poshnje” kanë kryer një volum të madh pune. Ajo ka nisur me pastrim dhe sistemim të zyrave, depove, magazinave, parqeve, grup depove të armatimit, kabinave elektrike, depove të ujit, rrugëve, bordurave, lulishteve, kanaleve etj. Ka vijuar me punimin e pemëve në të gjithë garnizonin. Komandanti i batalionit, nënkolonel Gëzim Marku, shprehet se në ditën e mjedisit u angazhuan shtabi i batalionit, kompanitë e këmbësorisë, ajo e mbështetjes dhe kompania e garnizonit me efektivat e tyre, të cilët bënë



të mundur mbjelljen e një sipërfaqe prej 6000 m², duke mbjellë 150 rrënjë ullinj, si dhe në bashkëpunim me Policinë Pyjore u punua për pastrimin e parcelës pyjore me pisha të krahut perëndimor të repartit me një sipërfaqe prej 5800 m² që u pastrua nga barërat e këqij, u bë krasitja e tyre, si dhe eliminimin e mbetjeve. Nënkolonel Marku, thotë për gazetën “Ushtria” se: “Ne, “Ditën e Mjedisit” e konsiderojmë një lloj si të

gjithë ditët e tjera dhe mund të pohoj se ka ndërgjegjësim të efektivave për të mbajtur pastër mjedisin ku ata stërviten dhe jetojnë, brenda garnizonit. Një mjedis i pastër pasqyron kulturë, shëndet dhe jetë, ndaj dhe kjo është motoja jonë, jo vetëm ta mbajmë atë pastër, por edhe ta pasurojmë në funksion të cilësisë së ajrit. Për këtë, kemi projekte konkrete për mbjelljen e sa më shumë pemë dekorative, ullinj etj”.

Ambasadori i Republikës Italiane viziton Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare

Më datën 27 shkurt, Ambasadori i Republikës Italiane në vendin tonë, zoti Massimo Gaiani, i shoqëruar nga një ekip drejtuesish të Guardia Financës dhe atasheu ushtarak gjeneralbrigade Vito Dell’ Edera, zhvilluan një vizitë në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD). Ambasadori dhe ekipi i tij u pritën nga drejtori administrativ i QNOD, zoti Maksim Malaj dhe stafi i koordinatorëve të qendrës. Mbasi i uroi mirëseardhjen, zoti Malaj prezantoi punën dhe përpjekjet e institucionit që ai drejton për monitorimin e situatës detare veçanërisht mbas riparimit të radarëve të SIHVD. Më pas zv/drejtori i qendrës, zoti Astrit Alija, bëri një prezantim të misionit të QNOD, bashkëpunimin ndërinstitucional, strukturën aktuale, operacionet e zhvilluara, regjimi juridik, burimet e informacionit, vëzhgimi dhe monitorimi i hapësirës detare, trajnimet e realizuara me personelin e qendrës dhe institucionet pjesëmarrëse, bashkëpunimin me ICITAP, PAMECA, GF dhe VRMTC për arritjen e objektivave dhe standardeve të kërkuara, etj. Ndërkohë zoti Maksim Malaj i njohu vizitorët me projektet e parashikuara në të ardhmen për zhvillimin dhe modernizimin e QNOD si dhe mundësitë e bashkëpunimit me palën italiane në realizimin e tyre. Gjeneral Luciano Carta, komandant i “Guardia Financës Italiane” theksoi bashkëpunimin e deritanishëm me Policinë tonë Kufitare, anti-kontrabandën detare dhe institucione të tjera për parandalimin dhe bllokimin e trafikeve të ndryshme midis dy brigjeve tona. Gjithashtu u nënvizua bashkëpunimi i frytshëm midis dy vendeve tona mbas viteve ‘90, kur institucionet tona ishin të brishta, dhe tashmë me konsolidimin e tyre nevoja e GF është pakësuar, por në kushtet e reja nevoja për bashkëpunim reciprok ekziston



përsëri, pasi kemi det të përbashkët. Ky bashkëpunim mund të thellohet në fushën e shkëmbimit të informacionit, përdorimin e integruar të tij së bashku me marinat e dy vendeve. Zoti Malaj evidentoi rëndësinë e mbështetjes dhe bashkëpunimit me palën italiane për rritjen e kapaciteteve operacionale të QNOD, e cila i shërben sigurisë në det, dhe për këtë problem nuk mungon as vullneti politik. Gjatë takimit u diskutua nga të dy palët për fushat dhe mundësitë konkrete të bashkëpunimit sidomos në shkëmbimin e informacionit. Drejtuesi Ali Elezi vuri në dukje bashkëpunimin disaveçar midis Policisë Kufitare dhe GF, për të cilat ekzistojnë dhe marrëveshje të cilat duhen respektuar në vijimësi sipas parimeve të reciprocitetit. Ekspertë italianë vlerësuan bashkëpunimin e mëparshëm në fushën e arsimit të specialistëve tanë në shkollat italiane, një bashkëpunim shumëvjeçar që ka mundësi të zgjerohet, po ashtu shkëmbim eksperiencash midis specialistëve të dy vendeve, shtimin e pikave të kontaktit për çështje me interes të përbashkët, etj. Zoti Mark Stickevers, përfaqësues i ICITAP në QNOD, vlerësoi rivënie në punë të SIHVD si dhe domosdoshmërinë e bashkëpunimit më të mirë të institucioneve ligj-zbatuese të shtetit shqiptar për zbatimin e ligjshmërisë në det. Mbas takimit ambasadori Massimo Gaiani dhe ekipi i tij vizituan sallën operacionale të QNOD ku u njohën nga afër me punën e personelit të kësaj sale për ndjekjen e situatës detare. Në fund të vizitës ambasadori italian falënderoi zotin Maksim Malaj për pritjen dhe vlerësoi përpjekjet e personelit të QNOD për kontrollin e hapësirës detare. Para largimit ekspertët e dy vendeve diskutuan shkurtimisht planet dhe projektet e bashkëpunimit me QNOD.

Shefqet Kërcelli

Mësim tregues për përballimin e situatave emergjente të shkaktuara nga përmbytjet

Viti 2014, si objektiv themelor ka rritjen e cilësisë së stërvitjes dhe përmirësimin e standardeve. Me këtë synim u realizua mësim tregues i datës 26 shkurt 2014 i zhvilluar me efektivin e t1k1k dhe “t2k1k”, të këtij batalioni me temë: “Veprimet e togës së këmbësorisë për eliminimin e pasojave të shkaktuara nga përmbytjet”, aktivitet i cili zhvillohet në kuadrin e planit të mësimave tregues dhe përgjithësues për vitin 2014, që ka ky batalion. “Qëllimi i këtij mësimi tregues, thekson nënkolonel Gëzim Marku, ishte aftësimi i nën-reparteve të batalionit për të koordinuar dhe zbatuar në praktikë veprimet për përballimin e situatave emergjente të shkaktuara nga përmbytjet, si dhe unifikimi i metodës së mësimdhënies nga drejtuesit e stërvitjes gjatë organizimit dhe zhvillimit të stërvitjeve të kësaj natyre”. Mësimi tregues u zhvillua sipas një plan metodik të hartuar më parë, ku u qartësua rajoni ku do zhvillohej mësimi, elementet që aplikohen, të gjitha këto sipas udhëzimeve, duke zbatuar me përpikëri rregullat e sigurimit teknik gjatë përdorimit të varkave dhe pajisjeve të tjera për kërkim-shpëtimin dhe evakuimin, si dhe u mbajtën parasysh rregullat dhe udhëzimet për mbrojtjen e ambientit. Gjatë improvizimit të situatave të kërkim-shpëtim, u testuan pajisjet që përdoren në emergjencë të tilla, si dhe procedurat e punës nga stafi drejtues dhe personeli ushtarë dhe nënoficer pjesëmarrës në stërvitje. Në përfundim të stërvitjes me të gjithë personelin pjesëmarrës u zhvillua analizë, gjatë të cilës u analizuan të gjitha mangësitë dhe problemet që u konstatuan në stërvitje, si dhe u evidentuan mësimet e nxjerra për stërvitjet e ardhshme.

Major Nexhbedin Basha



Ministrja Kodheli inspektoi stërvitjen ndërinstitutionale “Pulëbardha 14-01”

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, në datën 25 shkurt, ka inspektuar stërvitjen e përbashkët “Pulëbardha 14-1”, zhvilluar nga Qendra e Simulimit dhe Qendra Ndërinstitutionale Operacionale Detare (QNOD). Në këtë aktivitet merrnin pjesë gjithashtu zëvendësambasadori i SHBA në Tiranë, z. Henry V. Jardine, atashe ushtarakë të akredituar në vendin tonë, përfaqësues të ICITAP, PAMECA, drejtorë drejtorish në MM dhe SHPFA, etj. Ministrja Kodheli u njoh nga afër nga drejtuesit e stërvitjes me qëllimin dhe skenarët e kësaj stërvitjeje, me fazën parapërgatitore, pjesëmarrësit dhe objektivat që synohen të arrihen në përfundim të kësaj stërvitjeje. Gjithashtu ajo vlerësoi shkallën e lartë të përgjegjësisë dhe profesionalizmit të pjesëmarrësve dhe inkurajoi për të rritur më shumë gamën e stërvitjeve të tjera në këto institucione të rëndësishme. Kjo është një stërvitje që zhvillohet për herë të parë në nivel ndërministror, me



përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes; Ministria e Brendshme; Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministria e Transportit dhe e Infrastrukturës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Kulturës, Ministria e Mjedisit, Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë. Gjithashtu të pranishëm ishin: zëvendësambasadori i SHBA

në Tiranë, z. Henry V. Jardine, atashe ushtarakë të akredituar në vendin tonë, përfaqësues të ICITAP, PAMECA IV etj. Qëllimi i stërvitjes “Pulëbardha 14-01” ishte rritja e ndërveprueshmërisë së këtyre institucioneve nëpërmjet përfaqësuesve të tyre dhe operimi sa më i shpejtë që të jetë e mundur për përballimin e problematikave të ndryshme me të cilat

përballen këto institucione. Disa nga objektivat e kësaj stërvitjeje ishin: rritja e njohurive dhe nivelit të kuptueshmërisë rreth misionit dhe përgjegjësisë të QNOD nga ana e ministrive pjesëmarrëse dhe agjencive mbështetëse; vlerësimi i nivelit të bashkëpunimit dhe koordinimit midis institucioneve pjesëmarrëse në QNOD në zbatimin e ligjit në det; transferimi i autoritetit komandues në operacion nga një institucion te një institucion tjetër i QNOD; shkëmbimi efikas i informacionit ndërmjet QNOD dhe agjencive të vendeve fqinje; rritja e nivelit të shkëmbimit të informacionit mes institucioneve dhe me vendet partnere etj. Pas përfundimit me sukses të kësaj stërvitjeje të gjithë pjesëmarrësit e institucioneve kanë rritur më tej aftësitë e tyre profesionale dhe janë në gjendje të analizojnë situata të ndryshme, të marrin vendime sa më të sakta për zgjidhjen në kohë sa më të shpejtë të situatave problematike të krijuara dhe për një zbatim më efektiv të ligjit në det.



Pulëbardhat “pluskojnë” në valët virtuale të Qendrës së Simulimeve

Mbyllet me sukses stërvitja “PULËBARDHA 14-1”

Qendra e Simulimit dhe Qendra Ndërinstitutionale Operacionale Detare zhvillojnë stërvitjen “Pulëbardha 14-1”

SHEFQET KËRCELLI

Ishte ndjesi e veçantë ndjekja e fazës finale të stërvitjes “Pulëbardha 14-1”, pasi kjo stërvitje nuk zhvillohej në det të hapur, por në ambientet e Komandës së Doktrinave dhe Stërvitjes, në Qendrën e Simulimeve, një nga institucionet më të reja të FA. E krijuar më 24.10.2012, dhuratë e Departamentit të Shtetit të SHBA, qendra JCATS (JOINT CONFLICT AND TACTICAL), konflikti i përbashkët dhe simulime taktike, nëpërmjet mijëra programeve që simulon i ka shërbyer më së miri trajnimit dhe rritjes së aftësive profesionale të qindra ushtarakëve shqiptarë, kuptohet në radhë të parë paqeruajtësve tanë. Një qendër me histori të shkurtër, por me produktivitet për Forcën tonë të Armatosur, pasi me kosto shumë të ulët arrihen objektiva të përafërt me stërvitjet në teren. Në fakt sa herë prek ambientet e KDS, si ish-ushtarak një valë kujtimesh zgjohet në memorien time, por kërkohet për të ndjekur këtë stërvitje i trazonte ato në shumë mënyra, në përpjekje për të lidhur të kaluarën dhe të tashmen e këtyre mjediseve, ku në kuptimin e plotë “gëlon” jeta ushtarake. Mëngjesin e datës 25 shkurt bashkë me kolegët e mi të Forcës Detare ndjek me vëmendje ngritjen e flamurit tonë kombëtar dhe më pas i



drejtohem i dyerve të Qendrës së Simulimeve, ku major Lulzim Saliu, Shef i Planifikimit të kësaj qendre dhe zoti Tonny Darlington, specialist i CUBIC, po hapnin dyert për pjesëmarrësit e shumtë të kësaj stërvitjeje. Si personel i kësaj qendre që në krijimin e saj, ata më flasin qetësisht për morinë e stërvitjeve të realizuara deri tani. Stërvitja që po zhvillojmë tani është në zbatim të direktivës së NATO-s, BS753, thotë major Saliu. Kuptohet që stërvitjet me tematikë detare kanë veçoritë e veta, “Pulëbardha 14-1” është e dyta e këtij lloji, ndaj kërkoi kujdes që në planëzim, ndërtim skenarësh, bashkërendimit të tyre, hedhja në Database me të gjitha

elementët, kushtet hidrolundrimore e teknike, përpunimin e tyre dhe kalimin normal të procesit stërvitor në të gjitha fazat e nivelet. Z.Tonny na flet me entuziazëm për zhvillimet e ecurinë e qendrës, por dhe për kënaqësinë që krijon pjesëmarrja e personelit të institucioneve detare në këtë stërvitje. Qendra gumëzhin në çdo kohë nga zërat e ushtarakëve të FT që trajnohen në të, por këtë radhë këta njerëz i krijojnë një atmosferë tjetër thotë Tony. Është një stërvitje që po ecën mirë, me skenarë specifikë për situatat në det, një bashkërendim efikas, sinkronizim i 3 grupeve njëkohësisht, zgjidhje situatash e marrje vendimesh individuale e në grup,

komunikim me telefon e radio, pra një stërvitje komplekse që i shërben më së miri trajnimit të çdo pjesëmarrësi në të. Ndjem mirë që jam mes detarëve, por shoh që dhe ata ndjehen mirë në mjediset e qendrës e mbyll bisedën z. Darlington. Të njëjtën mendim ndajnë dhe kapiten Herald Selmani, shef i degës teknike të qendrës, rreshter Sazan Shehi, specialist i programeve, etj. Në këtë qendër specialistë amerikanë e shqiptarë punojnë e trajnohen së bashku, miqësi që shprehet dhe në simbolin e saj. Data 25 shkurt ishte dhe dita e vizitorëve të stërvitjes. Në të mori pjesë Ministrja e Mbrojtjes, zonja Mimi Kodheli, drejtues e përfaqësues nga

Ministria e Brendshme dhe Rendit Publik, Ministrisë së Financave, të Transportit, Bujqësisë, Mjedisit, diplomatë dhe atashe ushtarakë të vendeve mike, etj. Fillimisht në sallën e konferencave të KDS, personaliteteve të larta civile dhe ushtarakë i uroi mirëseardhjen drejtori i ri i QNOD, zoti Maksim Malaj. Më pas Komandanti i Qendrës së Simulimeve në KDS, kolonel Dritan Demiraj i shpjegoi pjesëmarrësve misionin, rolin dhe kapacitetet e qendrës së simulimeve në përgatitjen dhe trajnimin e personelit të FA. Personeli i qendrës së bashku me pajisjet e bazën teknike bashkëkohore përbën një aset me vlerë të pazëvendësueshme për Forcat tona të Armatosura, theksoi kolonel Demiraj. Në vijim zoti Malaj i njohu pjesëmarrësit me misionin e QNOD, strukturën dhe bashkëpunimin ndërinstitutional, operacionet detare, vëzhgimi e monitorimi i hapësirës detare, etj. Gjithashtu ai u ndal gjerësisht në qëllimin, objektivat, strukturën dhe planifikimin e stërvitjes “PULËBARDHA 14-1”, që nga skema e organizimit të pjesëmarrësve, detyrat dhe skenari i stërvitjes, shpërndarja e aseteve të institucioneve, kalendari dhe pjesëmarrësit në stërvitje, plani i vendosjes dhe organizimit të personelit, plani i komunikimit dhe vlerësimin mbyllës të stërvitjes. “Pulëbardha” i shërbeu më së miri rritjes së aftësive individuale të oficerëve të shërbimit, koordinatoreve të institucioneve pjesëmarrëse në



QNOD, operatorëve dhe drejtuesve të mjeteve detare dhe bashkëpunimit ndërmjet përfaqësuesve të institucioneve, në vlerësimin e situatave, marrjen e vendimeve të sakta, nënvizoi ish-generali. Gjatë stërvitjes u realizuan disa objektiva të rëndësishme që kanë të bëjnë me rritjen e aftësive individuale të stafit të shërbimit dhe koordinatorëve të institucioneve pjesëmarrëse në QNOD për përgjegjësit e tyre, testimi dhe vlerësimi i procedurave të miratuara duke përfshirë modelet dhe listat standarde. U bë vlerësimi i efikasitetit e nivelit të koordinimit midis QNOD dhe ministrive dhe agjencive mbështetëse dhe kalimi i përgjegjësisë së operacionit nga një institucion tek tjetri sipas ndryshimit të regjimit të operacioneve. Dhe struktura ishte njehsuar me atë reale, që nga oficerit programues i stërvitjes dhe oficerit që zhvillon stërvitjen. Një strukturë e plotë që nga drejtuesi i stërvitjes, vlerësuesit, imituesit, kontrolli i lartë, forca për situatën, simulimi, mbështetja e kushteve të jetesës me pjesëmarrës nga MM, MB, MMj, MF, MTI, MBZHRAU, MZHUT, etj. Ishte një QNOD e plotë, me koordinatorë, oficerët e shërbimit dhe operatorët të akomoduar e përshtatur mirë në panelet operacionale të Qendrës së Simulimeve, me dëshirën e mirë për tu stërvitur maksimalisht duke përvetësuar çdo element të skenarëve të improvizuar. Kuptohet që këto lloj stërvitjesh më këtë nivel, numër pjesëmarrësish dhe skenarësh duan kohën e vet. Ndaj stërvitjes finale i paraprinë një varg konferencash që nga ajo e datës 14.10.2013, që bëri specifikimet e stërvitjes dhe shënoi fillimin e saj, e cila u pasua me konferencën fillestare të planëzimit, më 10.01.2014 dhe u mbyll me konferencën kryesore të planëzimit më 05.02.2014. Ndërsa nga data 14-25 shkurt u zhvillua stërvitja me gjithë

personelin e institucioneve pjesëmarrëse të QNOD ku u përfshinë dhe kapiten-eritë e porteve Shëngjin, Durrës, Vlorë, Himarë, Sarandë, QBO, Agjensi lokale, polici, zjarrfikës, spitale, partnerë rajonalë e NATO-s, etj. Për më se dy javë u praktikuan situata të ndryshme që kërkonin organizim të operacioneve të kërkimshpëtimit dhe ndihmës në det, monitorim të vazhdueshëm të hapësirës

detare, bashkërendim me agjensitë e tjera përgjegjëse, informim dhe komunikim të vazhdueshëm. Operacione për kontrollin e kufijve detare, kalim të paligjshëm të kufirit e qenieve njerëzore, mallrave, peshkim të paligjshëm, ndjekje e mjeteve detare të dyshimta, trafiku ilegal dhe krimi të organizuar, qenieve njerëzore, lëndë narkotike dhe kontrabandë detare. Të tjera operacione për mbrojtjen e mjedisit detar, monitorimi i hapësirës detare nga ndotjet, parandalimi dhe eliminimi i tyre; një realitet virtual i servitur nga mjeshtrët e JCATS, një pamje e plotë për emergjencat detare e mirëorganizuar e funksionale, të cilin QNOD dhe institucionet pjesëmarrëse në të e përdorin çdo ditë. Gjatë këtyre ditëve u trajnuan oficerë të shërbimit të turnit, koordinatorë institucionale, operatorë. Në përfundim të stërvitjes ky personel është në gjendje të analizojë, koordinojë dhe zhvillojë këto veprime në përputhje me procedurat standarde operacionale SOP të QNOD, tha zoti Malaj. Ndërkohë specialisti i CUBIC, zoti Dee Esplin, duke i ftuar vizitorët për ndjekjen e stërvitjes nënvizoi se në tre sallat e qendrës krijohen situata të tilla që mund të përjetohen në cdo situatë detare, një mot me rrebesh e bubullima, një det i rëndë me dallgë disa ballësh, njerëz të këqij e shkelës të ligjit, kontrabandës të mallrave e narkotikëve. Kjo qendër përveç shërbimit ndaj Forcave të Armatosura mund të shërbejë dhe për institucione



Qëllimi i stërvitjes "Pulëbardha 14-1"

Qëllimi i stërvitjes "Pulëbardha 14-1" ishte rritja e ndërveprueshmërisë së institucioneve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në det, nëpërmjet operimit dhe koordinimit sa më të shpejtë për përballimin e problematikave të ndryshme me të cilat përballen këto institucione. Stërvitja "Pulëbardha 14-1" zhvillohet për herë të parë në nivel ndërministror, me përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministria e Transportit dhe e Infrastrukturës, Ministria e Zhvillimi Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Kulturës, Ministria e Mjedisit dhe Ministria e Financave.

shtetërore civile të sigurisë së brendshme, ashtu si në SHBA, theksoi zoti Esplin. Në vijim zonja Kodheli dhe vizitorët e tjerë ndoqën konkretisht veprimet e pjesëmarrësve sipas situatave të dhëna. Përfaqësuesi i antikontrabandës detare, Shkëlqim Hajdini i shpjegoi ministres veprimet e grupit të tij gjatë një situatë kur një anije peshkimi kryen peshkim të paligjshëm. Kapiten Gjergji Koco dhe Urim Bulica i tregojnë veprimet e ekuipazheve të anijeve të FD së bashku me helikopterët dhe kapitenerinë e Durrësit, për ti shpëtuar jetën personelit të një tragekti të mbytur në ujërat tona, inspektor Ali Dervishi dhe Alfred Cela sqarojnë një rast të ndalimit të trafikut të qenieve njerëzore, kap.lt. Julian Skoti dhe Klaudio Aliaj ndjekjen e një situatë ndotje detare, ndërsa specialisti i ri i MMj, Irsid Gjika, i shpjegoi zv.ambasadorit të SHBA, zotit Henry Jarnet, veprimet që kryhen për eliminimin e këtyre ndotjeve. Të përqendruar në monitorë, të gjithë kanë çfarë të tregojnë. Ministria Kodheli u ndal dhe bisedoi për disa minuta me komisar Ilia Nanon mbi veprimet e Policisë Kufitare për parandalimin e trafikëve të lëndëve narkotike dhe kontrabandës gjatë bregdetit tonë, ku u vlerësua rëndësia e riparimit të radarëve të SIHVD. Një stërvitje me plot dinamikë, situatë e veprime të gjithanshme. Kap.lt. Elvis Cenka, zyra QS, një nga protagonistët e "Pulëbardhës" thotë se qendra krijon mundësinë e angazhimit të gjithë personelit të QNOD, imiton situatë të rëndësishme deri në detaje, teston gatishmërinë e mjeteve të ndryshme të çdo institucioni dhe kohën e reagimit të tyre. Gjatë inspektimit Ministria Kodheli vlerësoi punën e aftësitë e çdo pjesëmarrësi të stërvitjes dhe falenderoi organizatorët e saj. Zv/drejtori i QNOD, zoti Astrit Aliaj na sqaron se në përfundim të stërvitjes, specialistët e operacioneve të institucioneve pjesëmarrëse në QNOD, bashkë me specialistët e Qendrës së Simulimeve, do bëjnë vlerësimin përfundimtar dhe paketën e materialeve të stërvitjes të cilat do shpërndahen në mars 2014. Gjithsesi personeli i institucioneve pjesëmarrëse të QNOD, mbas lundrimit dy javor në virtualitetin e miqësinë që afroi Qendra e Simulimeve, ndjehen më të aftë e të sigurt për tu përballur me dallgët e detit në shpëtim të jetës së njerëzve si dhe zbatimin e ligjshmërisë detare në ujërat tona.

FA, kryen fazën e tretë të pastrimit

Efektivët e FT vazhdojnë të kontribuojnë në rehabilitimin e mjedisit

Më datë 22 shkurt 2014, Forcat Tokësore, u angazhuan për rehabilitimin e mjedisit dhe pastrimin e akseve kryesore rrugore në vend përfshi pikat doganore, Qafë-Thanë e Kapshticë si dhe Portin e Durrësit. Batalionet e këmbësorisë Shkodër, Tiranë, Berat, si dhe të batalionit Komando e atij të Forcave Speciale morën pjesë në operacion me pjesën më të madhe të efektivit, si dhe mjetet e tyre të transportit. Pikat më sensitive ku u përqendrua kryerja e punimeve ishin Qafë Thanë e Kapshticë, ku ishin përqendruar forcat kryesore. Me pjesën tjetër të forcave u punua në drejtimit Vorë-Durrës, Librazhd-Qafë Thanë, Korçë-Bilisht. Efektivët u inspektuan nga ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli, ministri i Mjedisit, z. Lefter Koka, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral major, Jeronim Bazo dhe komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku. Nga ana e tyre u vlerësua puna e bërë dhe u shprehën falenderimet për të gjithë personelin e angazhuar në operacion. Efektivët e Forcës Tokësore, bënë të mundur vendosjen në normalitet mjedisor të këtyre akseve rrugore dhe pikave doganore, me synimin që në të ardhmen këto zonat të menaxhohen lehtë nga strukturat përgjegjëse.

Forca Ajrore vazhdon aksionin për pastrimin e territorit

Efektivët e Forcës Ajrore, më datën 22.02.2014 në fazën e tretë të pastrimit, vazhduan operacionin për pastrimin e territorit në aksin rrugor Aeroporti "Nënë Tereza"-Fushë-Krujë. Në këtë fazë efektivët e Forcës Ajrore të angazhuara me 60 vetë dhe 5 mjete, me këmbëngulje dhe seriozitet maksimal, kanë pastruar këtë aks prej 11.2 km të gjatë nga mbetjet. Në këtë aksion u grumbulluan 12.5 ton mbeturina të cilat u transportuan për në landfillin e Fushë-Krujës. Efektivët e Forcës Ajrore u inspektuan gjatë gjithë ditës nga komandanti i Forcës Ajrore gjeneralbrigade Frederik Beltoja, i cili i falënderoi ata për përkushtimin e treguar edhe në këtë ditë pastrimi.

FD në aksion për mjedisin

Më datën 22 shkurt mbi 100 kuadro dhe detarë të Forcës Detare morën pjesë në aksionin për pastrimin e mjedisit në rrugën nacionale Ura e Dajlanit-kryqëzimi Maminas, rreth 15 km gjatësi. Si rezultat i punës së



palodhur së këtij personeli, pavarësisht reshjeve të shiut që nuk pushoi gjithë ditën, u arrit të grumbullohen dhe evadohen 10 ton mbeturina. Përkushtimi i efektivit të FD për të pastruar mjedisin u vlerësua nga komuniteti dhe drejtuesit e pushtetit vendor në Rashbull, Sukth e Maminas.

Brigada Logjistike pastrojnë 10 kilometra të rrugës nacionale Pogradec Kapshticë

Gjashtëdhjetë efektivë të Brigadës Logjistike pastruan mbi 10 kilometra të rrugës nacionale Tiranë Kapshticë në segmentin Pogradec Qafë Pllocë. Ditën e shtunë më datën 21 shkurt 2014 autokolanë e Brigadës Logjistike që herët në mëngjes u nis nga Tirana për të shkuar në Pogradec të drejtuar nga Komandanti i Brigadës gjeneralbrigade Syrja Gjoka, shefi i operacioneve nënkolonel Maksim Oranlliu dhe nga zëvendëskomandantët e reparteve. Në orën 9.00 filloi operacioni për pastrimin e dy anëve të rrugës nacionale ku në të kishte një sasi të konsiderueshëm mbeturinash. Në harkun e rreth 6 orëve u grumbulluan mbi 20 ton mbeturina të cilat u sistemuan në thasë dhe pastaj

u ngarkuan në makina dhe u transportuan për në landfillin e Pogradecit. Të gjashtëdhjetë forcat e kësaj Brigade punuan me shumë përkushtim dhe duke zbatuar rregullat e përcaktuara nga autoritet e pushtetit vendor. Po ashtu tre mjete të Batalionit të transporteve shkuan që një ditë para në rrugën nacionale Korçë-Kapshticë dhe ditën e shtunë ishin në gatishmëri për të pastruar grumbulluar mbeturinat dhe për ti dërguar ato në vendgrumbullim. Operacioni u vlerësua nga Ministria e Mbrojtjes nga Shtabi i Përgjithshëm dhe nga autoritet e pushtetit vendor. Nënkolonel Maks Oranlliu cilësoi se operacioni ishte i organizuara me shumë saktësi dhe kthimi në Tiranë u krye me shumë korrektësi. Ky operacion tregoi se efektivët e kësaj njësie kryen detyrat sipas planit të përcaktuar. Ky është operacioni i tretë i pastrimit dhe do të vazhdojë edhe në javën e ardhshme.

Vijon kontributi i BRmR për pastrimin e mjedisit

Në vijim të nismës "Shqipëria është e të gjithëve, ta mbajmë atë të pastër", më datë 22.02.2014 Brigada e Mbështetjes Rajonale u angazhua në

LETËR E HAPUR

Të çlirojmë vendin nga plehrat që i kanë zënë frymën

Të nderuar qytetarë,
përfaqësues të shoqatave dhe të shoqërisë civile që përfshini një gamë të gjerë të aktivitetit tuaj, që nga mbrojtja e mjedisit e deri tek mbrojtja e të drejtave të Fëmijëve dhe të Njeriut, përfaqësues të komunitetit të biznesit, përfaqësues të shkollave, grupimeve dhe organizatave të rinjve shqiptarë. Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, të Republikës së Shqipërisë, prej disa javësh, në vijim të vendimit të Komitetit Ndërmënyor dhe porosisë së Kryeministrit të Shqipërisë z.Edi Rama, ka ndërmarrë një aksion në shkallë të gjerë për pastrimin e gjithë territorit, me synimin final për të krijuar një mjedis sa më të pastër dhe mikpritës. Në përpjekjet tona për zgjidhjen e kësaj situate emergjente të krijuar prej vitesh, kemi gjetur mirëkuptimin e strukturave të tjera shoqërore apo dhe pushtetit vendor, por fatkeqësisht në nivele që lënë për të dëshiruar. Por që aksioni ynë të ketë rezultate akoma edhe më të mira, është e domosdoshme përfshirja e të gjithë komunitetit, shoqatave të biznesit, organizatave të ndryshme, nxënësve të shkollave dhe studentëve, që si një trup i vetëm të çlirojmë rrugët, bregdetin, mjedisin tonë nga plehrat që i kanë zënë frymën. Duke qënë se Shqipëria është porta e Ballkanit, duke qënë se Shqipëria në qershor të këtij viti pret të marrë statusin e vendit kandidat për në BE për t'u bërë pjesë e familjes së madhe evropiane, duke qënë se jemi në prag të hapjes së sezonit turistik, në emër të jetës, në emër të fëmijëve tuaj, apelojmë për një gjithëpërfshirje të qytetarëve që kërkojnë një Shqipëri të pastër dhe atraktive, bashkohuni me ne, në aksionin për pastrimin e Shqipërisë ditën e shtunë. Le të tregojmë dhe ne shqiptarët kulturë europiane, dashuri ndaj ambientit dhe gjithçkaje që na rrethon, dhe në radhë të parë dashuri për veten tonë dhe jetën e fëmijëve tanë. Shqipëria është e jona, është vendi ku ne kemi jetuar me mijëra vjet, jetojmë me njerëzit tanë më të dashur dhe vendi në të cilin do të jetojmë ne dhe fëmijët tanë. Që ta ruajmë atë sa më të pastër, bashkohuni me ne, me kauzën tonë që është kauzë e të gjithë shqiptarëve. Shqipëria ka nevojë për të gjithë ne!

Singerisht, Mimi Kodheli

pastrimin e akseve rrugore Qafë Thanë – Rrajcë – Pishkash, Cangonj – Bilisht, Kapshticë – Gryka e Cangonjit, Ura e Lizës – landfili i Elbasanit, në një shtrirje prej 41 km. Në këtë aksion u angazhuan 91 forca dhe 13 mjete duke pastruar dhe transportuar 147 m3 mbetje urbane drejt landfillit të Elbasanit dhe Bilishtit si dhe gjërmim dhe nivelim dherash 350 m3.

Vijon faza e tretë e pastrimit të mbetjeve të integruara urbane

Në fazën e tretë të nismës "Shqipëria është e të gjithëve ta mbajmë

atë Pastër dhe shpalljes së emergjencës civile për gjendjen e mjedisit, Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes është angazhuar në aksin rrugor Elbasan-Librazhd duke pastruar këtë aks në një shtrirje prej 11 Km. Kjo komandë angazhoi rreth 110 forca dhe 6 mjete duke bërë të mundur pastrimin dhe transportimin e rreth 18 ton mbetje urbane drejt landfillit të Librazhdit. Ky aksion u ndoq nga afër nga Zv/ Komandanti i KDS-së Kolonel Ruzhdi Kuçi. Ne këtë aksion morën pjesë Kursantë të AFA-së, ShT dhe Shtabi i KDS-së.

QAME realizon tjetër operacion, certifikohen tunelet e Shmilit

Certifikohen katër tuneleve të nëndheshme të Shmilit në prefekturën e Tiranës. Ky operacion është një tjetër arritje e Brigadës Logjistike dhe reparteve të saj, në procesin shumë të vështirë dhe me përgjegjësi të procesit të demontimit dhe të asgjësimit të municioneve të tepërta. Në operacionin e pastrimit të kontrollit të imtë dhe të verifikimit të certifikatës së pastërtisë të këtyre katër tuneleve është puna disa mujore e efektivit të rajonit të Tiranës por dhe e reparteve të tjera të Brigadës, të drejtuar nga nënkolonel Hiqmet Hoxha efektiv i rajonit të Tiranës në bashkëpunim me efektivin e "Qendrës së Asgjësimit të Municioneve me Eksploziv", me "Batalionin e Transportit" dhe me "Batalionin e Municioneve" mundësuan heqjen e

mbi 300 tonë municioneve këmbësorie, predhave të artilerisë dhe të mortajave si dhe municioneve të ndryshme xheniere. Terreni shumë i vështirë, vjetërsia e municioneve, rreziku i tyre i madh në transport i këtyre municioneve që kishin kohë që ishin magazinuar në këto tunele u kapërcyen nga ana e efektivit të oficerëve dhe të efektivit ushtarak që shërbente në këto tunele, ndaj Vlerësim i parë shkon për punën e këtyre efektivave të cilat punuan edhe jashtë orarit të punës dhe në kushtet e vështira të motit për të hequr 300 tonë municione dhe për t'i magazinuar në Burizane të Krujës. Certifikimi i këtyre tuneleve është vazhdim i asaj pune shumë voluminoze të rrezikshme dhe me përgjegjësi të madhe që është bërë nga ana e Komandës së Brigadës Logjistike, Shtabit të Brigadës, të shefave të shërbimeve

që kanë marrë përgjegjësinë që të ndjekin deri në detaje tërë këtë operacion. Këto dy muaj kjo Brigadë ka bërë certifikimin e grup-depove të Murrashit në Rajonin e Elbasanit dhe pas certifikimit të sotëm të katër tuneleve të Shmilit dhe janë në prag të certifikimit grup-depot e Guakut në Skrapar dhe të Mbreshtanit në Rajonin e Beratit. Puna do të vazhdojë me shumë përgjegjësi me korrektësi dhe bashkëpunim në grup i gjithë reparteve do të arrijë të plotësojë tërë detyrat që vijnë nga Ministria e Mbrojtjes, dhe nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura. Ndaj dhe një herë për të vlerësuar punën e gjithë efektivit dhe i falënderojmë ata për këtë arritje në këtë operacion të vështirë.

Bashkim Male

Siguria e analizuar në kontekstin e BE dhe ndikimi i saj mbi vendin tonë

Nga: Agron Loci

Për cilindo prej nesh, do të mjaftonin vetëm pak minuta duke lundruar me telekomandën e televizorit në programet që vijnë në shtëpitë tona falë valëve satelitore, apo të kontaktonim mediet e ndryshme, për të konstatuar se nëse ka një çështje për të cilën ka qaq shumë interes sot në botën tonë të globalizuar ajo është siguria. Nisur nga rëndësia që ka garantimi i sigurisë, nuk është i rastësishëm fakti që çdo vit zhvillohen qaq shumë takime apo konferenca të niveleve më të larta politike dhe teknike në nivel global, nuk është i rastësishëm fakti se këto diskutime janë të përditshme në të gjitha nivelet e organizmit institucional, madje nuk është i rastësishëm gjithashtu fakti i rëndësisë që i kushtohet njohjes së konceptit të sigurisë dhe plazmimit të tij në praktikë, saqë këto çështje janë kthyer sot në pjesë integrale e kurrikulave të shumë shkollave të niveleve të ndryshme.

Në fund të fundit, ky interesim i gjithanshëm shpjegohet me bindjen se garantimi i sigurisë do të mundësonte jetën normale të njerëzve, do të mundësonte zhvillimin në një mjedis të sigurt të biznesit dhe të jetës të çdo genie njerëzore në planetin tonë dhe se për këto arsye kjo është dhe mbetet detyra kryesore e të gjitha institucioneve të shtetit.

Por, koncepti i sigurisë, si pasqyrim i realiteteve të përditshme ka edhe ai dinamikën e zhvillimit të tij. Nuk do të ishte e vështirë të konstatohej se aktualisht përveç dimensionit tradicional fizik, garantimi i sigurisë në një masë të konsiderueshme kërkon edhe njohjen e parandalimin e rrezeveve edhe në nivelin virtual dhe eterik, pra në nivelet më të larta të zhvillimit të teknologjisë të realizuar deri më sot nga mendja njerëzore. Do të mjaftonte vetëm një shkelje e një taste të kompjuterit për t'i shkaktuar njerëzimit dëme aq të mëdha saqë pasojat e të cilit të sjellin ndërmend shprehjen e Ajnshajnit se "...nuk e di se me cilat armë do të bëhet Lufta e 3 Botërore por di që Lufta e 4 Botërore do të luftohet me shkopinj dhe gurë".

Si një vend evropian me objektiva të përcaktuara strategjike për të qenë pjesë e BE, ne jemi të interesuar të njohim rreziqet dhe kërcënimet me të cilat përballet sot BE. Kjo është e domosdoshme jo vetëm se ne dëshirojmë të jemi pjesë e unionit por edhe për faktin se këto kërcënime në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë janë edhe sfida për Shqipërinë dhe institucionet tona. Po cilat janë disa nga kërcënimet dhe sfidat me të cilat përballet sot BE?

Në një analizë më konkrete nuk është e vështirë të konstatohet se aktualisht në nivelin evropian ekzistojnë rreziqe të cilat në mënyrë të shkëlqyeshme apo në bashkëpunim me njëri tjetrin mund të minojnë përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar por edhe tonat për të garantuar një mjedis sa më të qetë dhe të sigurt. Këto rreziqe mund të klasifikohen si rreziqe të natyrës strukturore të brendshme të vetë BE si dhe si rreziqe të jashtme kryesisht të natyrës gjeopolitike.

Në të vërtetë, po të marrësh në analizë realitetin nuk ka sesi të mos bie në sy fakti se aktualisht ne jetojmë në një botë ku dinamika e zhvillimeve ka dy tendenca kryesore : është e paparashikueshme dhe shumë e diversifikuar. Të ndodhur



përballet këtij fakti ne jemi të detyruar që këtë realitet ta njohim sa më mirë në mënyrë që të jemi në gjendje të marrim masat e duhura në mbrojtje të sigurisë, qetësisë apo punës dhe të ardhmen e shtetasve tanë.

Një ndër kërcënimet aktuale për BE është rritja e frymës së euroskepticizmit. Vetëm një dekadë më parë shumë pak studiues mund ta kenë parashikuar se pas 10 vjetësh do të kish një nivel qaq të lartë të skepticizmit mbi BE fenomen ky që vërehet kryesisht në vendet më me influencë dhe me kontribute më të mëdha anëtare të unionit. Sigurisht që ky perceptim lidhet me faktorë të natyrave të ndryshme qofshin këto politike, ekonomike, sociale apo edhe kulturore të cilat në realitet duke ndërvepruar me njëra tjetrën rezultojnë në rënien e entuziazmit për BE.

Fryma euroskeptike, megjithëse fillesat i ka që nga koha kur Britania drejtohej nga kryeministria konservatore Theçer, sot konsiderohet si një fenomen me mbështetje gjithnjë e në rritje jo vetëm në Britaninë e Madhe por ajo që po bie në sy është fakti se ajo po përhapet edhe në shumë vende të tjera. Përveç UKIP në Britaninë e Madhe, sot në mjedisin politik evropian kanë mbështetje të konsiderueshme edhe parti të tjera euroskeptike si AfD në Gjermani, Fronti Kombëtar në Francë, Partia për Lirinë në Holandë, Partia e Lirë austriake, Lega Nord në Itali e deri në gadishullin skandinav ku politikën dhe partitë euroskeptike kanë rritur ndjeshëm mbështetjen e tyre.

Ajo që shqetëson politikën por edhe shoqërinë civile në shumë vende të BE është fakti se në këtë simfoni forcash politike me prirje euroskeptike, shpesh ndërthuren edhe elemente të ideologjisë populiste dhe ksenofobe të cilat rrezikojnë dhe minojnë sigurinë. Janë të njohur qëndrimet radikale ndaj fesë myslimane të liderit të ekstremit të djathtë në Holandë Wilders, një ndër kundërshtarët e vendosur për mos dhënien e statusit kandidat për vendin tonë në dhjetor të vitit të kaluar, qëndrime këto të sintetizuara në shprehjen e tij "Unë nuk urrej myslimanët, unë urrej Islamin". Nëse mbështetja ndaj Wilders, Le Pen, UKIP etj do të rritej

atëherë padyshim që kjo frymë populiste dhe euroskeptike do të ndikonte tek niveli i sigurisë dhe qetësisë në Evropë e për pasojë shumë kush mund ta ndjente veten të kërcënuar.

Për fat të keq realiteti tregon se kjo mbështetje ka ardhur duke u rritur. Wilders vazhdon të mbetet pikë referimi dhe presioni ndaj qeverisë aktuale në Holandë, UKIP ka rritur mbështetjen në elektoratin britanik, AfD, parti e krijuar vetëm një vit më parë në Gjermani nuk arriti për vetëm pak vota që të kishte përfaqësuesit e saj në Bundestag, ndërkohë që simotra e saj austriake arriti të jetë në parlament. Në të njëjtën kohë që një vend në zemër të Evropës por që nuk është anëtar i BE, vetëm dy javë më parë me referendum miratoi mbështetjen popullore për t'i mbyllur dyert të huajve dhe krijuar kështu një ishull anti emigracion në zemër të BE. Ajo që bie në sy në këtë fenomen është se nëse nga njëra anë kemi rritjen dhe konsolidimin e tendencave euroskeptike e populiste nga ana tjetër vihet re një rënie e mbështetjes për forcat politike me programe liberale. Madje në Gjermani për herë të parë që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore në Parlamentin federal nuk do të jetë e pranishme Partia Liberal-Demokrate, një forcë politike që kishte gëzuar gjithnjë mbështetjen e elektpratis për të qenë e pranishme në institucionin ligjvënës. Të dhënat flasin se pjesa më e madhe e votave për këtë parti liberale shkuan për partinë euroskeptike, tregues ky që ka ngjallur një debat të konsiderueshëm në vend.

Në fakt rritja e mbështetjes së tyre në popull konfirmohen jo vetëm nga sondazhet në nivel kombëtar por edhe nga sondazhe të organizuara nga një institucion i tillë që monitoron prirjet dhe tendencat e zhvillimeve në nivel evropian siç është Eurobarometri. Ajo që bie në sy është se këto parti priten që të kenë mbështetje të madhe në zgjedhjet për parlamentin e ri evropian që do të mbahen gjatë muajit maj në të gjitha vendet anëtare të BE.

Ky realitet i ri kërkon që politika shqiptare duhet të jetë e përgatitur për t'u përballur me të madje duhet ta marrë seriozisht në konsideratë duke pasur

parasysh se në muajin qershor kur është parashikuar që të diskutohet mbi statusin e vendit kandidat vendimmarrja duhet të kalojë edhe në Parlamentin Evropian në të cilin pritet që në qershor numri i deputetëve me prirje euroskeptike të jetë më i lartë krahasuar me të gjitha legjislaturat e mëparshme.

Një tjetër tendencë që vihet re dhe që në një farë mase pasqyrohet edhe tendosjet brenda BE është perceptimi që kanë një numër i konsiderueshëm banorësh në disa vende anëtare lidhur me kontributin dhe garancinë që ofrojnë një pjesë e vendeve brenda unionit. Kriza ekonomike financiare që mbërtheu Greqinë dhe që kërkoi ndërhyrjen e fuqishme të institucioneve evropiane për ta shpëtuar vendin nga falimentimi por edhe kriza italiane, ajo spanjolle e portugeze kanë ravijëzuar një perceptim që shkon në një ndarje veri – jug.

Në një pjesë të konsiderueshme të njerëzve që jetojnë në këto vende është krijuar përshtypja se kemi të bëjmë me dy modele të ndryshme të drejtimit të shtetit, nëse vendet e Evropës qendrore, veriore e perëndimore kanë arritur të ndërtojnë këtë venë në efikasitet institucione shtetërore të besueshme dhe më pak të korruptueshme e kundërta ndodh me vendet e Evropës Jugore por edhe Lindore të cilat kanë demonstruar deficite të konsiderueshme në përmbushjen e detyrimeve si ndaj shtetasve të tyre ashtu edhe ndaj unionit prandaj konsiderohen edhe si barrë për vendet e tjera. Këto deficite dhe vështirësi përkthehen në kosto financiare për buxhetin e përbashkët dhe njëkohësisht edhe në qëndrimin e vlerësime negative për vendet në vështirësi.

Kjo ka krijuar një hendek në aspektin sesi banorët respektivë e shohin dhe konsiderojnë njëri tjetrin. Paragjykimet dhe stereotipet për pjesë të ndryshme të kontinentit sigurisht që nuk i shërbejnë sigurisë dhe integritetit të brendshëm të bashkimit evropian. I ndërtuar duke pasur në bazë koherencën Bashkimi Evropian do të detyrohej të vuate nga shumë probleme madje të rrezikohej për të ekzistuar nëse kjo koherencë do të humbiste.

Sinjale paralajmëruese për të qenë të kujdesshëm dhe për të përmirësuar gjithnjë e më tepër instrumentet strukturore e legjislativë përsa i përket garantimit të sigurisë vijnë edhe përtej kufijve të Bashkimit Evropian.

E ashtuquajtura pranvera arabe, megjithë arritjet në demontimin e sistemeve autoritariste dhe diktatoriale përsëri "eksporton" rreziqe dhe kërcënime drejt kontinentit evropian. Çështja e emigracionit ka kohë që diskutohet në kancelaritë e shumë vendeve evropiane dhe megjithë "solidaritetin" dhe "përkrahjen" për emigrantët përsëri nuk është arritur të gjendet gjuha e përbashkët sa kohë që shtete të ndryshme anëtare të unionit e shohin dhe e vlerësojnë këtë çështje në këndvështrime të ndryshme nisur nga interesa të ngushta kombëtare.

Statistikat nga Europol dhe agjenci të tjera flasin se së bashku me emigrantët e paligjshëm në BE hyjnë edhe elementë me precedentë penalë, individë që i përkasin grupeve dhe organizatave terroriste dhe që kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vendet e unionit.

Por, përveç tyre BE është i detyruar të marrë në konsideratë edhe rolin e disa aktorëve të rëndësishëm gjeopolitikë siç janë Rusia dhe në një farë mase edhe Turqia,

vende këto që ndodhen në kufijtë natyralë me BE. Rëndësia e këtyre vendeve për sigurinë e BE lidhet me një sërë faktorësh siç janë numri i popullsisë dhe i madhësisë gjeografike të tyre, vendndodhja në kufijtë me BE, aksesit i tyre në burime të rëndësishme energjetike por edhe si vende transite për kalimin në BE jo vetëm të rezervave energjetike aq të nevojshme për konsumatorin dhe ekonominë evropiane por edhe të dukurive dhe fenomeneve kërcënuese që barten nga individë por edhe organizata të ndryshme, deri tek ndikimi i lidershit të tyre në politikën e vendeve fqinje, pa lënë pas dore edhe ndërtimin e funksionimit të sistemeve politike në këto vende.

Në dhjetë vitet e fundit Rusia është rikthyer fuqishëm në arenën ndërkombëtare si një aktor i rëndësishëm. Duke shfrytëzuar burimet e saj energjetike, kaq të rëndësishme për shumë vende anëtare të BE, ajo ka treguar se në momente të caktuara mund të luajë fort me kartën e furnizimit me energji të Evropës dhe të përpiket që të mbrojë interesat e saj përkundrejt interesave të BE në tërësi dhe të shteteve të veçanta anëtare të unionit në veçanti. Ngjarjet e muajve të fundit në Ukrainë, ku humbën jetën qindra njerëz, janë një tregues kuptimplotë se megjithë përparimet e mëdha të bëra në fushën e sigurisë BE nuk është imun ndaj kërcënimeve të reja. Ishte pikërisht përplasja për të ardhmen e Ukrainës që shpuri në konfliktin jo vetëm të brendshëm mes mbështetësve të qëndrimeve të ndryshme në Ukrainë por edhe në divergjencat dhe këndvështrimet e ndryshme ndërmjet Brukselit dhe Uashingtonit nga njëra anë dhe Moskës nga ana tjetër.

Një aktor shumë i rëndësishëm racional si dhe me një rëndësi të veçantë gjeopolitike për interesat dhe sigurinë e BE është edhe Turqia e cila ndryshe nga Rusia po përpiket që të forcojë dhe stabilizojë rolin e saj përmes rritjes së vullmit të tregtisë me prodhuesit lokalë duke e shtrirë atë edhe në procesin e përpunimit të mëtejshëm të mallrave. Duke parë se perspektiva e anëtarësimit të saj në BE nuk është shumë premtuese për shkak të qëndrimeve bllokuese të disa prej vendeve më me peshë të unionit, Turqia nën drejtimin e Erdogan po përpiket që të kthehet në një superfuqi jo vetëm ekonomike por edhe politike të rajonit. Qëndrimet e lidershit aktual politik të Turqisë ndaj Izraelit, ndaj zhvillimeve në Siri, në lidhje me marrëdhëniet me Iranin, Irakun apo me disa nga ish republika të BS shpesh kanë qenë në qendër të vëmendjes të kancelarive më të rëndësishme në botë.

Si konkluzion mund të thuhet se Shqipëria për vetë objektivat strategjike që ka është tejet e interesuar që të njohë dhe t'i paraprijë çdo lloj zhvillimi që ka të bëjë me sigurinë. Fenomene në dukje të largëta siç janë euroskepticizmi, dukuria e emigracionit në të tëra dimensionet dhe shtrirjen e saj, e deri tek ndikimi i politikave të faktorëve globalë dhe rajonalë, kanë pa asnjë dyshim ndikimin e tyre qoftë ky i drejtpërdrejtë apo dhe i tërthortë mbi vendin tonë. Duke njohur realitetin për politik-bërësit shqiptarë është e rëndësishme ndryshimi i perceptimit e për rrjedhojë i aksionit duke kaluar nga përballimi i skenarëve dhe krizave afat shkurtra në përpilimin e strategjive afat gjatë ku të përfshiheshin të gjithë elementët strukturore dhe instrumentale për të garantuar sigurinë dhe qetësinë për shtetasit tanë.

Aty ku besueshmëria është në rendin e ditës

Nga Azem PARLLAKU
Julis SELAMAJ

Antonio Machado ka thënë “Rrugë s’ka, rrugë bëhet duke ecur” e në këtë kuptim nëse shohim rrugëtimin e Laboratorit Qendror të Forcave të Armatosura, vërejmë se ky institucion, ka siguruar tashmë pozicionin e një strukture serioze, ku zhvillohen dijet dhe ku shkenca, zë vendin e duhur në podiumin e elitës profesionale. Në këtë konkluzion, doli këto ditë dhe ekipi i auditimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, e cila është organi më i lartë në Shqipëri, për akreditimin e laboratorëve dhe trupave certifikues. Që nga viti 2007, vit në të cilin është akredituar Laboratori Qendror i Forcave të Armatosura, i nënshtrohet në mënyrë permanente auditimit nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit. Me të drejtë lind pyetja: Çfarë e lidh këtë laborator me Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit? Kjo ndërveprueshmëri e ka zanafillën në vitin 2007, kur Drejtoria e Akreditimit, kreu vlerësimin e kompetencës së Laboratorit Qendror, në bazë të kërkesës së tij, për t’u akredituar sipas standardit ISO 17025, e në këtë mënyrë ai të kishte kompetencën e laboratorit testues dhe kalibruës. Kjo kërkesë erdhi si rezultat i punës dhe profesionalizmit për ta ngritur Laboratorin Qendror të Forcave të Armatosura në një nivel të lartë teknik dhe me sistem të kompletuar të sigurimit të cilësisë. Vendimi për akordimin e statusit të akreditimit për këtë laborator, shënoi një arritje shumë të rëndësishme për vetë laboratorin, ndërkohë dhe për Forcat e Armatosura, të cilat kanë ditur të mbështesin dhe vazhdojnë të investojnë për cilësinë, si element i rëndësishëm i progresit të tyre. Struktura e Laboratorit Qendror të Forcave të Armatosura është e ndërtuar në bazë të manualeve, rregulloreve dhe standardeve të funksionimit të laboratorëve testues, sidomos në standardin ISO 17025 2006. Kjo strukturë nga viti në vit ka ardhur duke u konsoliduar për një funksionim sa më eficient dhe profesional. Laboratori Qendror është strukturë e para e Forcave të Armatosura që ka realizuar akreditimin nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, në fushën e testimeve laboratorike për 100 parametra testues që nga viti 2007 e vazhdim. Kryesisht janë analizat e karburant/lubrifikantëve, ushqimeve, municioneve, lëndëve plasëse, ujërave të pijshëm, ujit industrial, dherave, lëndëve ndotëse, dhe lëndëve helmuese luftarake, ato që nxjerrin në pah përmbushjen e standardit ISO 17025. Referuar këtij standardi Laboratori Qendror, ka përmbushur pjesëmarrjen në teste ndërlaboratorike si brenda dhe jashtë vendit. Sipas Marcel Proust “Udhëtimi i vërtetë i zbulimit nuk konsiston në kërkimin e peizazheve të reja, por në gjetjen e arritjen e vështrimeve të reja” të cilat Laboratori Qendror i ka përmbushur duke funksionuar; Si një strukturë operacionale e disponueshme e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura në qdo moment, sa herë që është e nevojshme për të kryer testime laboratorike në një kohë minimale, shërbim i cili nuk mund të ofrohet nga institucione jashtë strukturave të Forcave të Armatosura si, analizimi i municioneve, baruteve, lëndët plasëse e NBC. Krahas kësaj këtu përmbushen

Nëpërmjet studimeve të kryera dhe testeve laboratorike Laboratori Qendror i Forcave të Armatosura u ka dhënë dhe u jep zgjidhje shumë problematikave, duke u evidentuar kështu si një kontribuues i vlefshëm për sigurinë. Kontrolli i testit të zotësisë PT nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit evidentoi ecuri, ku besueshmëria rritet çdo ditë

më së miri detyrimet e Objektivave të Forcës në fushën e CBRN në fushën e monitorimit dhe mbrojtjes së mjedisit dhe cilësisë së artikujve në përdorim nga Forcat e Armatosura, fushë specifike e cila mbulohet vetëm nga specialistët e këtij laboratorit të cilët janë trajnuar dhe specializuar në vite nga organizma ndërkombëtar dhe vende anëtare të NATO-s. Si strukturë ka kontribute të veçanta në ndjekjen e shumë operacioneve me rrezikshmëri të lartë, aktiviteteve e prioritetëve të Qeverisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes, si asgjësimi i kimikateve të rrezikshme ndër vite si; LHL, kripërat e metaleve të rënda, asgjësimi i lëndës tymuese, ambalazhimi i kimikateve e mallrave stoqe në Forcat e Armatosura. Sipas drejtorit të këtij laboratorit nënkolonel Adriatik Spahiu “Nëpërmjet studimeve të kryera laboratorit u ka dhënë zgjidhje problematikave të dala gjatë procesit të demontimit të municioneve në rrugë industriale, monitorimit të mjedisit, tokë, ujë, ajër, ujërat e shkarkimeve të industrisë ushtarake, ujërat e puseve që përdoren nga njësitë ushtarake, e ujin e Detit. Është strukturë bashkëpunuese me projekte të Komunitetit European (Greqi, Estoni, Zvicër, Slloveni) në fushën e testimeve laboratorike, ku është veçuar për konformitetin e rezultateve të raportuara. Laboratori Qendror ka një staf i cili, angazhohet në aktivitete kërkimore shkencore, konferenca kombëtare e ndërkombëtare si dhe kualifikim mastera profesional, shkencor e doktoratura. Kredibiliteti i Laboratorit Qendror të Forcave të Armatosura njihet dhe vlerësohet nga Drejtoria e Akreditimit, Drejtoria e Standarteve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Prokuroria e Përgjithshme, Instituti i Shëndetit Publik, Instituti i Kërkimeve Veterinare dhe Ushqimit, Agjensitë Rajonale të Mjedisit, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti Politeknik, ECBC (USA), Laboratori Spiez (Zvicër), Laboratori Thun (Zvicër).

Nga tre në një

Me një të kaluar e cila ka zanafillën aty në vitin 1954, Laboratori Qendror i Forcave të Armatosura është strukturë e akredituar që prej vitit 2007, fakt ky që çon tek rritja e besueshmërisë së aktivitetit testues, kapaciteteve njerëzore profesionale dhe procedurave standarde që aplikohen këtu. Teksa lëmë pas “Kafen e Rremës”, diku jo shumë larg përbri rrugës kombëtare që lidh kryeqytetin me rrethinat e tij, disloket Laboratori Qendror i Forcave të Armatosura. Ndërsa kërkim më tepër për këtë institucion, arkivat na shpjen në vitin 1954, kur nisi të funksionojë Laboratori i Intendencës, atëherë në vartësi të Drejtorisë të Prapavijës. Më vonë në vitin 1964, “një inxhinier kimist dhe një teknik i mesëm laborant” ishin personeli i Laboratorit të Kimisë, ky në vartësi të Drejtorisë të Kimisë. Kurse Drejtoria e Armatim-Municionit, në vitin 1974 edhe ajo do të kishte në vartësi Laboratorin e Municioneve. Në vitin 1996 të tre laboratorët e mësinërm u organizuan

në një të vetëm, si Laboratori Qendror i Forcave të Armatosura në vartësi të Drejtorisë së Logjistikës. Riorganizimi i vitit 2003 këtë laborator e pozicionoi si pjesë të strukturës së Komandës së Mbështetjes Logjistike. Në vitin 2007 ishte Brigada e Logjistikës, ajo që në strukturën e saj e kishte të kompletuar Laboratorin Qendror të Forcave të Armatosura. Me riorganizimin e Forcave të Armatosura vitin e kaluar, Laboratori Qendror i është bashkangjitur strukturës organizative të Regjimentit të Mbështetjes së SHPFA. Ndoshta jo shumë i artikuluar, fakti tregon që ky institucion i ka shërbyer më së miri kërkesës së Forcave të Armatosura, për specifikën e detyrave të cilat ai ka kryer e vijon të kryejë. Stilema “testime laboratorike” mbeti, e kështu do vijojë të jetë e patjetërsueshme për të gjithë detyrat premtuese të Laboratorit Qendror të Forcave të Armatosura. Objekti i punës të këtij laboratorit është, sigurimi dhe mbështetja e përgjithshme laboratorike dhe shërbime analitike për furnizimet materiale sipas klasave të furnizimit, ku përfshihen pajisjet NBC e pajisje të tjera të vëna në përdorim të Forcave të Armatosura. Përtej këtij objekti Laboratori Qendror si strukturë operacionale e me detyra specifike, ka privilegjin e bashkëpunimit me institucione shkencore brenda dhe jashtë vendit si askush tjetër prej strukturës së Forcave të Armatosura. Nisur nga ratifikimi dhe implementimi i stana-geve e ligjeve mjedisore ky laborator disponon pajisje, personel të specializuar, e procedura testuese për të përmbushur një mision unik në Republikën e Shqipërisë. Implementimi i këtyre stanageve i jep Forcave të Armatosura ndërveprueshmëri për cilësinë e materialeve që testohen në Laboratorin Qendror. Ai ka patur dhe ka bashkëpunime me projekte të Komunitetit European në fushën e testimeve laboratorike, ku është veçuar për konformitetin e rezultateve të raportuara. Nga ky laborator janë kryer e kryhen testime laboratorike për mostra të ndryshme si, ujë, kar-



burant, produkte ushqimore, etj. Rezultati i këtyre analizave, ka qenë mjaft i saktë e i njësuar me laboratorë kimik të rajonit dhe Europës. Bashkëpunimi me laboratorët e ushtrisë Zvicerane në fushën e analizave të substancave toksike, si dhe në fushën e testimeve të baruteve dhe lëndëve plasëse, e evidentojnë dukshëm aktivitetin e këtij institucioni. Kontributet në mbështetjen e punës kërkimore shkencore për individë të Forcave të Armatosura, si dhe stafëve kërkimore shkencore jashtë Forcave të Armatosura i rrisin ende më shumë kreditet për këtë laborator. Nga stafi këtu janë kryer disa kërkime shkencore individuale në shërbim të Forcave të Armatosura, e është bërë mbrojtje masteri nga ana e gjashtë personave. Mbështetja për individët jashtë strukturës së Forcave të Armatosura për kryerjen e studimeve të Doktoraturës, ka vijuar të mbetet gjithnjë e më shpesh e kërkuar. Bashkëpunimi në studime të ndryshme, si monitorimi dhe analizimi i PCB-ve në vajin e transformatorëve që disponohen nga njësitë e Forcave të Armatosura dhe në shumë raste edhe nga njësitë vendore, janë dëshmi e bashkëpunimit brenda vendit. Studimet e përbashkëta me laboratorët e ushtrisë Zviceriane, ku i fundit është ai me Laboratorin e Thunit, mbi vlerësimin e rrezikut të ndotjes së mjedisit në Uzinë e Lëndëve Plasëse në Mjekës, janë fryte të bashkëpunimit jo nacional. Kredibiliteti i Laboratorit Qendror të Forcave të Armatosura njihet dhe vlerësohet nga Drejtoria e Akreditimit, Drejtoria e Standarteve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Prokuroria e Përgjithshme, Instituti i Shëndetit Publik, Instituti i Kërkimeve Veterinare dhe Ushqimit, Agjensitë Rajonale të Mjedisit, Fakulteti i Shkencave Naty-

rore, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti Politeknik, ECBC (USA), Laboratori Spiez (Zvicër), Laboratori Thun (Zvicër). Laboratori Qendror i Forcave të Armatosura është strukturë e akredituar që prej vitit 2007, fakt ky që çon tek rritja e besueshmërisë së aktivitetit testues, kapaciteteve njerëzore profesionale dhe procedurave standarde që aplikohen në këtë laborator. Në disa fusha për analiza të tilla si Lëndët Helmuese Luftarake, Mjetet e Mbrojtjes Kundrakimike, lëndët degazuese, municionet dhe lëndët plasëse, ky laborator është unik në Republikën e Shqipërisë.

Përkujdesja dhe implementimi i standarteve

Koha është minimale sa herë është e nevojshme për të kryer detyrat specifike të testimeve laboratorike dhe me një cilësi e shërbim që nuk mund të ofrohet nga institucione jashtë strukturës së Forcave të Armatosura, e bëjnë operacionale Laboratorin Qendror. Vizioni këtu është testimi laboratorik i artikujve që gjejnë përdorim dhe mendohet të jenë pjesë e kompletimit për Forcat e Armatosura, duke patur prioritet që këto artikuj të jenë cilësisht konform standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare. Përmbushja e detyrimeve për Objektivat e Forcës në fushën CBRN, në fushën e monitorimit dhe mbrojtjes së mjedisit, mbeten të përditësuara në aktivitetin e këtij laboratorit. Kontributet e veçanta në mbështetjen e operacioneve të tilla si, asgjësimi i kimikateve të rrezikshme ndër vite, demontimi i municioneve të tepërta, asgjësimi i stoqeve dhe materialeve që nuk mund të jenë në përdorim, angazhimet e vazhdueshme në mbështetje të Emergjencave Civile, e bëjnë Laboratorin Qendror një kontribuues të vlefshëm për sigurinë.



Vizioni i Direktivave të Mbrojtjes 2014 nën këndvështrimin e një jete rekreative në FA

Aprovimi së fundi nga znj. Ministre e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, i “Festivalit të Parë të Filmit Dokumentar Ushtarak” (FFDU) të vendeve të NATO-s, është një aktivitet konkret në zbatim të Direktivave të Mbrojtjes 2014

Aleksandër GJONAJ*

Dokumenti strategjik i Direktivave të Mbrojtjes 2014 të afron shumë pamje leximi. Dhe padyshim në qendër të saj është marrëdhënia e ushtarakut me komunitetin civil. Në konceptin e artit modern ushtarak është tashmë e qartë se ndërveprimi i situatave ushtarake dhe atyre civile përbëjnë një hallkë të rëndësishme në jetën aktive të Forcave të Armatosura. Në kohën e sotme rindërtimi dhe rikonsolidimi i hallkave lidhëse të tyre përbëjnë një domosdoshmëri për një stabilitet të ekuilibruar dhe jo formal. Në këto kushte ngritja në një shkallë më të lartë të këtyre niveleve përbën një domosdoshmëri, gjë që është në përparësitë dhe objektsonet e strategjisë së mbrojtjes për vitin 2014. Kjo përbën një nga prioritetet kryesore të objektivave tona që rezonojnë një përfaqje më kombëtare të Politikës së re të Mbrojtjes në fushën e edukimit, nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme kulturore-artistike si edhe të ruajtjes dhe pasurimit të trashëgimisë sonë kulturore. Aprovimi së fundi nga znj. Ministre e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, i “Festivalit të Parë të Filmit Dokumentar Ushtarak” (FFDU) të vendeve të NATO-s, është një aktivitet konkret në zbatim të Direktivave të Mbrojtjes 2014.

Gjerësia e veprimtarive të tilla si edhe cilësia dhe serioziteti i organizmit të tyre në jetën e ushtarakëve ka bërë të mundur ndryshimin e një mentaliteti më modern të konceptit të ushtarakut. Jeta e ushtarakut sot është më e gjerë dhe interesat intelektuale të tij kërkojnë nivele të larta të aktiviteteve rekreative për vetë faktin se formimi i tij nuk është i lidhur vetëm me mjedisin ushtarak, (jeta e kazermës dikur), por është pjesë e një familje, grupi shoqëror dhe komuniteti më të gjerë njerëzish. Unë dua të besoj se gjeneza e veprimtarive artistike dhe kulturore është e lidhur



me Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë jo për faktin se këto lloj aktiviteteve kanë zanafillën me formacionet e para të çetave patriotike dhe më vonë të atyre partizane, por edhe për vetë faktin se në filozofinë e Forcave të Armatosura mbrojtja e vlerave të kulturës si dhe promovimi i tyre është një me misionin e saj. Forcat e Armatosura duke mbrojtur tërësinë territoriale të Shqipërisë, njëkohësisht evoluojnë konceptet e shqiptarëve për mënyrën e edukimit të tyre patriotik dhe kombëtar. Domosdoshmëria e zhvillimit të kësaj fushe të edukimit nëpërmjet aktiviteteve informative me këtë temë, në këtë kontekst përbën gjithashtu një obligim për ne që në themel të filozofisë sonë kemi edukimin e fëmijëve të ushtarakëve si edhe të tyre nëpërmjet artit. Dhe forma më e duhur është aktivitetet masive në këtë fushë. Eksperiencat e strukturave të ngjashme të Forcave të Armatosura të vendeve të tjera të botës, (Itali, Kroaci, Rumani, Turqi, etj) sigurisht që na mundësojnë ne që këto struktura të artit dhe kulturës, komunikimeve “on-

line”, prodhimeve multimediale si edhe të aktiviteteve informative, të mundohemi ti “shkrijmë” me strategjinë ushtarake. Ngacimi dhe inkurajimi i dimensioneve krijuese brenda figurës së ushtarakut si dhe përfaqësimi tyre sa më gjerë do të thotë njëkohësisht edhe kultivim dhe rritje e inteligjencës së tyre. Risia kryesore jona është që strukturat kulturore Brenda Forcave të Armatosura të rinovojnë energjitë e tyre krijuese nëpërmjet aktiviteteve mbarë komunitare të cilat kanë një kohëzgjatje gjatë gjithë vitit kalendarik. Jo rastësisht në radhët e Ushtarakëve të Forcave të Armatosura gjenden krijues që u përkasin fushës së letërsisë, arteve pamore, interpretimit etj. Muzeu i Forcave të Armatosura është një tjetër fokusim ku vëmendja jonë do të ketë një përparësi për vetë faktin e vlerave dhe objekteve muzeore që mbart ky muze. Numri në rritje i vizitorëve na impenjon akoma më shumë për projekte aktiviteteve me një larmi që do të jetë një risi tjetër si për nga gjerësia e tyre ashtu edhe nga këndvështrimi i veçantë.



Pjesë e kësaj pune është edhe certifikimi i Muzeut të Forcave të Armatosura. Në matricën e veprimtarive kryesore të QKMBM-së janë planifikuar një numër i madh aktiviteteve të cilat do të kenë si suport Muzeun e Forcave të Armatosura si edhe ambientet e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes. Menaxhimi si edhe promovimi i këtyre standardeve bashkëkohore sigurisht kërkon një përkushtim por edhe një vlerësim etik për to. Thelbi i konceptimit të këtyre aktiviteteve qëndron në aktualitetin e zhvillimit të Forcave të Armatosura, në atë ç’ka është më e evidente, pra në konceptin modern të përfshirjes së tyre si një pjesë aktive e shoqërisë civile. Është detyrë e jona që këto nocione të realizohen me sukses. Kjo gjë mund të arrihet nëse të gjitha hallkat e strukturave funksionojnë në harmoni si dhe arrijnë të bashkëveprojnë përshtatshmërisht nga lart poshtë dhe anasjelltas ashtu siç parashikohet në Direktivat e Strategjisë së Mbrojtjes për vitin 2014. Iniciativa e fundit e Ministrisë së Mbrojtjes për një territor më të pastër dhe më të kulturuar

është një konkretizim i funksionimit dhe bashkëveprimit të këtyre hallkave në shtrirje më të gjerë. Promovimi i këtyre mundësive si edhe përpjekja e përbashkët e Forcave të Armatosura dhe shoqërisë civile është një konkretizim i një bashkëpunimi frytdhënës. Tabu të vjetra bien dhe në vend të tyre lindin ide dhe njëkohësisht “zgjohen” energji të pa shfrytëzuara më parë. Nuk ka si të mos ndihesh mirë kur shikon sensibilizimin e gjithë shoqërisë shqiptare për një kulturë dhe hapësirë më të mirë mjedisore... Sigurisht në këtë realitet ku përpjekjet për të ndryshuar mentalitete dhe njëkohësisht për të arritur rezultate do të vazhdojnë edhe më tej. Ato kurrsesi nuk do të mbeten në njohjen empirike të askujt, por do të vlerësohen si një aktivitet mbarëkombëtar që na shton përgjegjësitë dhe përkushtimin tonë. Ky është një pretendim sa optimist aq edhe i vështirë.

**Drejtor i “Drejtorisë së Aktiviteteve dhe Marrëdhënieve me Komunitetin”, QKMBM*

Specialistët e Laboratorit vihen në dispozicion, për çdo detyrë që ka të bëjë me testimin e artikujve që gjenë përdorim në Forcat e Armatosura, duke dhënë rekomandime e konsiderata të besueshme profesionalisht. Po ti referohemi eksperiencës, rezultoni se kur një shërbim testues është kërkuar të kryhet nga institucione të tjera, në disa raste ajo dhe është ofruar, por koha e marrjes së përgjigjes ka qenë shumë e gjatë, si dhe kostoja për shërbimin e kryer ka rezultuar relativisht e lartë. Ndërsa Forcat e Armatosura, tashmë e kanë luksin e të pasurit në strukturë Laboratorin Qendror, ndërsa eksperiencia e lartpërmendur thjesht mund të vlejë si referencë. Aktualisht Laboratori Qendror i kryen thajse të gjitha testimet për artikuj që gjejnë përdorim në Forcat e Armatosura në një kohë minimale dhe me më pak kosto, duke angazhuar gjithë kapacitetet kur detyra është e vendosur me afat apo kërkohet një mendim specifik. Konsolidimi i sistemit të cilësisë dhe

shtimi i gamës së parametrave analizues, është ambicie e vazhdueshme këtu në Laboratorin Qendror. Duke qenë i akredituar, roli dhe pesha e laboratorit, si dhe shërbimet që ai ofron, janë të mëdha, teksa cilësia dhe standartet duhen përmbyshur më së miri. Akreditimi për herë të dytë i Laboratorit, pas atij të kryer në 22 prill 2007 sipas kërkesave dhe standardit ISO 17025 dhe procedurave të Ministrisë së Ekonomisë, është përgjegjësi më e madhe jo vetëm për personelin këtu, por për të gjithë Forcat e Armatosura. Mbrojtja nën kontroll nëpërmjet analizave kimike, fiziko-kimike e fiziko-mekanike të municioneve, mjeteve të mbrojtjes kundërkimike, ushqimeve, karburant-lubrikantëve, veshmbathjes, si dhe bashkëpunimi me organet qendrore dhe vendore në raste të incidenteve kimike, mbeten prioritarë për këtë strukturë jo vetëm mbështetëse por dhe kërkimore-shkencore. Në laboratorin e municioneve shërbehet sipas provës së Vjelit,

ashtu sikurse aplikimi i metodës klasike mbetet thelbësore në përcaktimin e lëndës stabilizuese të baruteve. Analizat fiziko-mekanike për përcaktimin e gjendjes cilësore të municioneve është barometër në procesin e mbajtjes nën kontroll të tyre, duke shërbyer si garanci e patjetërsueshme në parandalimin e ngjarjeve të jashtëzakonshme, që mund të vijnë si rezultat i ritmeve të dekompozimit, apo pakujdesisë nga faktori njeri. Mbi këtë fakt tendenca qartësisht është orientuar në kontrollin e gjendjes së qëndrueshmërisë kimike të baruteve, si kusht e domosdoshmëri. Një mori provash ndër më kryesoret si; prova e stabilitetit nëpërmjet përcaktimit të përqindjes së lëndës stabilizuese HPTLC, prova e stabilitetit me metodën e vakumit VST, prova e stabilitetit me metodën e Vjelit, etj, janë pista të qarta për ku është orientuar aktiviteti në këtë laborator. Rivlerësimi i hermetizmit të ambalazheve ruajtëse të municioneve, rivlerësimi i aftësisë

marrëse “ndjeshmërisë” e transmetimi i impulsit fillestar në kapsollat ndezëse, koha e transmetimit të impulsit termik në ngadalësuesit, impulset detonuese në kapsollë, qëndrueshmëria e gëzhjojës, elementët piroteknik, efektshmëria shpërthyesë e ndriçuese, kontrolli i mekanizmave siguries, janë togfjalësja të rrjedhshëm në Laboratorin Qendror të Forcave të Armatosura. Kapacitetet testuese të Laboratorit në një vit i kapërcejnë dymijë mostra të municioneve, njëmijë mostrave të ushqimeve, veshmbathjes, karburant-lubrikantëve, e analizave mikrobiologjike, si dhe njëmijepesëqind parametrave të kimikateve të ndryshme të ujit. Si strukturë operacionale për kryerjen e detyrave specifike për Forcat e Armatosura, ky Laborator i shërben implementimit të standardeve dhe objektivave të fushës së mbrojtjes. Me specifikën e detyrave që kryen Laboratori Qendror, do të vijojë të mbetet një element i rëndësishëm

mbështetës i sigurisë, po kaq dhe i angazhuar në mënyrë permanente në situata bashkëpunuese dhe ato emergjente. Pavarësisht artikullimit sa më lart, është e udhës të mendojmë për një përkujdesje të veçantë për këtë aset unik të fushës së mbrojtjes. Sigurisht, që kjo përkujdesje do të promovonte ende më dukshëm kontributet e Forcave të Armatosura në interes të sigurisë. Aktualisht në vendin tonë qoftë organizmat qeveritare, ashtu dhe ato joqeveritare, e kanë fokusuar ndjeshëm vëmendjen në çështjet mjedisore. Ndërpunueshmëria me institucionet bashkëpunuese të përmendura më lart, do të sillte impakte pozitive për Forcat e Armatosura si zotëruese e këtij aseti të fushës së kimisë. Kështu është i nevojshëm të rishikohet kompletimi me sisteme dhe pajisje të kohës për këtë laborator, ndërkaj dhe kualifikimi i mjeteshëm i personelit kimist, gjë e cila do të mundësonte fleksibilitet dhe cilësi në çdo kohë dhe situatë.

Mbill Pemën Tënde

“Mbill Pemën Tënde është një aksion qytetar ku të gjithë njerëzit përfshihen në të vullnetarisht përmes dëshirës dhe kontributit modest, duke menduar një person të dashur me kujtime për të mbrojtur gjelbër qytetin dhe mbjelljen e një ose shumë pemëve. Ftesa është e thjeshtë për të kryer një punë vullnetare me qëllimin e vetëm që të shërbejmë në këtë qytet e për të dhënë një mësim qytetarie tek ata që sot përtojnë të ndiejnë atdhetari në zemrën e tyre. Nganjëherë, kur mendon se ç’pasoja të mëdha rrjedhin nga gjëra të vogla, bindem se nuk ka gjëra të vogla. Kjo shprehje e Bruce Fairchild Barton më bëhet të mendoj se nuk ka gjëra të vogla, por varet nga i sheh, si bëhen dhe sa të madh e kërkon mundin për një përpjekje si kjo Mbill Pemën Tënde.” - këto janë disa nga fjalët e Eljan Tanini, një prej nismëtarëve

të kësaj nisme të rëndësishme mjedisore, para fillimit të saj. Kjo iniciativë e iniciuar nga një grup të rinjsh, të ndikuar dhe nga një mësuese e tyre tepër aktive në jetën shoqërore dhe ndihmën ndaj komunitetit, Ina Kasimati, kanë ndërmarrë këtë nismë për ti dhënë shansin çdo të rrituri e çdo fëmijë që të rritet me pemën e tij, të kujdeset për pemën e tij, e ndërkohë ti japi një pamje akoma më të gjelbër qytetit. Kjo nismë nisi më 11 Janar të këtij viti me publikimin e nismës dhe u kurorëzua më 15 Shkurt ku vullnetarë të ndryshëm pasi kishin kontribuar me kursimet e tyre në një arkë të vendosur posaçërisht për këtë qëllim mbollën pemën e tyre pranë Parkut Rinia, pranë Liqenit Artificial etj. duke lënë secili dhe emrin mbi pemën e tij. Vetëm atë ditë janë mbjellë mbi 300 rrënjë bredha nga këta vullnetarë. Fil-

limi është sa gjethet, sa sythat e parë të pranverës që po çelin në këtë stinë. Ndaj angazhimi për të mbjellë pemën tënde në qytet do të thotë jo ta ndryshosh, por ta shndërrosh vendin, lagjen, hapësirën e gjelbër përmes kujdesit në distancë të pemës tënde. Por kjo nismë nuk u ndërpre këtu, ajo vazhdoi më tutje, kësaj radhe me kontributin edhe të Forcave të Armatosura. Kështu më 22.02.2014, vet ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli iu bashkua këtyre të rinjve dhe 40 forcave nga Akademia e Nënoficerëve “Thomson” për të mbjellë dhe ajo pemën e saj, pranë QSUT, me një thirrje për të gjithë qytetarët: “Unë e mbolla pemën time, mbill dhe ti pemën tënde”. Atë të shtunë kursantët e ANO nën drejtimin e zv/komandantit të saj, n/kolonel Mugamed Guza, i cili ka ndjekur nga afër të gjithë aktivitetin e



ANO-së gjatë gjithë këtyre të shtunave pastrimi e përkushtimi për sensibilizim mbarëkombëtar, mbollën rreth 150 rrënjë Pisha.Forcat e Armatosura kanë treguar këto kohë një ndjenjë tepër të lartë qytetarie, përgjegjshmërie dhe respekti ndaj mjedisit dhe vet jetës së tyre. Për të kontribuar për familjet e tyre, shoqërinë dhe komunitetin ata kanë qënë të parët që kanë

dhënë shembullin e tyre duke kontribuar në pastrimin e territorit të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet nismës “Shqipëria është e të gjithëve, ta mbajmë atë të pastër.” E ku ka më mirë se të jesh Ti shembulli i parë dhe pozitiv për ndërgjegjësimin e të gjithë qytetarëve për një Shqipëri më të pastër, më të gjelbër, për një Shqipëri ndryshe.

Nëntogere Morena Halilaj

Zhvillohet ceremonia e daljes në pension e Prof. Asc. Dr. Bashkim Elbasani

Urimi i përgjithshëm: Mirënjohje, respekt dhe lumturi

Në datën 24 shkurt 2014, në mjediset e QLMI, u zhvillua ceremonia e daljes në pension të Prof. Asc. Dr. Bashkim Elbasanit. Ceremonia mbresëlënëse e organizuar nga i gjithë stafi i QLMI, përkoi dhe me 65 Vjetorin e Lindjes së Profesor Elbasanit. Në këtë ceremoni morën pjesë zëvendëskomandanti i KDS, kolonel Ruzhdi Kuçi, drejtues të institucioneve, profesorë, miq e kolegë të profesorit, ish-studentë e familjarë. Në fjalën përshëndetëse të mbajtur me këtë rast nga drejtori i QLMI, Dr. Bernard Zotaj, ndër të tjerash u vlerësua maksimalisht puna ndër vite e profesor Elbasanit. Drejtori Zotaj theksoi se: “Mirënjohja është një fjalë zemre e madhe, e cila flet për punën, përkushtimin dhe për kontributin e gjatë dhe të vlerësuar në shkollat e Krujës, të Tiranës, të Turqisë dhe së fundi në shkollat ushtarake. Ju, Profesor, kini arritur të ndërtoni një profil të qartë dhe të spikatur të një personaliteti në fushën e matematikës shqiptare. Në shkollat ushtarake, Ju punuat në Universitetin Ushtarak “Skënderbej” dhe së fundi në Qendrën e Librit dhe Mbështetjes me Informacion. Kjo periudhë më ka dhënë mundësinë për të njohur, në kushtet e një ngarkese maksimale, të gjithë dimensionin profesional dhe njerëzor tuajin. Ju punuat në vendin ku përgatiten kuadrot e Ushtrisë, njerëzit e mbrojtjes dhe të sigurisë, njerëzit ku në çdo veprim dhe për çdo gjë mbi të gjitha kanë Atdehen, nderin dhe dinjitetin. Ju studentëve ushtarakë dhe civilë u shërbyet me përkushtim, duke ju dhënë më shumë njohuri, dashuri, mirësjellje dhe tepër kulturë. Në sytë tuaj u rritën dhe u burrëruan studentët, që tashmë me një pjesë të tyre u bërë kolege pune dhe profesor. Të gjitha aftësitë dhe mundësitë që kishe i vure në shërbim të mësimin dhe të dijes.” Brenda këtyre viteve profesor Bashkimi u kualifikua dhe kreu shkollat e kurse për të perfeksionuar e zgjeruar më tej njohuritë shkencore, duke merituar dhe titullin akademik “Prof. Asoc.”. Bilanci i punës së Prof. Bashkimit është mjaft domethënës. Ai ka demonstruar qartë profesionalizëm,



“Mirënjohja është një fjalë zemre e madhe, e cila flet për punën, përkushtimin dhe për kontributin e gjatë dhe të vlerësuar në shkollat e Krujës, të Tiranës, të Turqisë dhe së fundi në shkollat ushtarake. Ju, Profesor, kini arritur të ndërtoni një profil të qartë dhe të spikatur të një personaliteti në fushën e matematikës shqiptare”.

përkushtim, integritet dhe rigorozitetin e një studiuesi të pasionuar. Pikërisht në këtë drejtim, u ndal në fjalën e tij uruese edhe Pano Hallko, kolegu e miku i tij, shefi i sektorit të “Planifikimit dhe Përgatitjes për Botim të Librave”

në QLMI. Nëse do përpiqeshim të mblidhnim në pak germa atë fjalë, mund të themi se ideja e përcuar ishte se humbja më e madhe është ajo që na vjen nga erozioni i pajustificueshëm që pësoi sistemi arsimor këto dekada

dhe nga mungesa e pariparueshme që ndjehet prej ikjes së personaliteteve të spikatura të kësaj fushe, ashtu siç është Prof. Bashkim Elbasani. Ky i fundit, e deshi shumë arsimin, shërbeu me përkushtim, shkroi dhe botoi mbi 15

libra për matematikën, biostatistikën, trajtoi çështje të metodikës dhe të teorisë së lojërave etj., për të ngelur në jetë mësues dhe profesor i nderuar dhe i respektuar. Diskutime të lira dhe fjalë zemre pati dhe nga kolegë e bashkëpunëtorë të profesor Bashkim Elbasanit. “Mirënjohje, respekt dhe lumturi - Kohën e qëndrimit në punë e përfunduat me nder, me respekt, me dinjitet dhe me mirënjohje nga të gjithë: nxënës, student, ushtarak dhe civil të cilëve i mësove dhe ju dhe njohuri në shkencat natyrore” – ky ishte urimi i përzemërt i të gjithë stafit e personelit të QLMI për profesor Bashkim Elbasanin. Për kontributin dhe vlerat e dhëna në zhvillimin e pasurimin e arsimimit civil e ushtarak në FARSH, Profesor Bashkim Elbasanit iu akordua “Certifikata e Mirënjohjes” nga zëvendëskomandanti i KDS, Kolonel Ruzhdi Kuçi. Më pas, të gjithë të pranishmit në ceremoni, ndoqën një dokumentar mbi punën dhe veprimtarinë e Prof. Asoc. Dr. Bashkim Elbasanit. Ceremonia u mbyll në realizimin e një fotoje dhe kokteji të përbashkët me të gjithë të ftuarit, si dhe me urimin edhe për 65-vjetorin e lindjes.

NJOFTIM

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në fushën e arsimimit, Ministrisë së Mbrojtjes i është ofruar mundësia për të ndjekur studimet ushtarake në “Programin ndërkombëtar të luftës kundër terrorizmit në Universitetin Kombëtar të Mbrojtjes”, i cili është planëzuar të zhvillohet në periudhën 19.08.2014 – 19.06.2015, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

PËRSHKRIMI: Programi Ndërkombëtar i Luftës kundër Terrorizmit në Universitetin Kombëtar të Mbrojtjes është pjesë e programit rajonal të luftës kundër terrorizmit. Ky program ka një shtrirje akademike 10 mujore dhe iu ofron studentëve një perspektivë strategjike mbi ndryshimet e mjedisit global të sigurisë. Kandidaturat për këtë program duhet të jenë oficerë me gradë N/Kolonel-Kolonel ose civilë ekuivalent, me një eksperiencë pune jo më pak se 15 vjet. Është e këshillueshme pasja e një diplome universitare pasi ky program të ofron diplomë të nivelit master.

KRITERET:
Niveli i gjuhës
Grada
Të tjera

- anglisht (ECL) 90 pikë; TOEFL 83 pikë;
- N/Kolonel-Kolonel/Civil ekuivalent
- Kandidatët e propozuar të kenë objekt të punës përshkrimin e kursit.

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ
HISTORIAN USHTARAK

Problemet e zhvillimit të veprimeve luftarake gjatë LANÇ janë trajtuar gjerësisht në librin “Historia e LANÇ të popullit shqiptar” në katër vëllime. Në vëllimin e tretë dhe të katërt trajtohen edhe ngjarjet luftarake që përkohën me krijimin e funksionimin e Komandës e të Shtabit të ZIOp Vlorë-Gjirokastrë-Mallakastrës. Në shtjellimin e veprimeve luftarake po ndalem kryesisht në disa dukuri nga ku evidencohet roli i Komandës dhe i Shtabit të Zonës si urdhërdhënëse, organizatore e zbatuese e drejtpërdrejt në Lumin e Vlorës. Pozicioni gjeostrategjik dhe hapësira që mbulon gjeografikisht juridiksioni i Zonës është disi i veçantë duke kush-tëzuar veprimet luftarake si dhe rolin e Komandës e të Shtabit të ZIOp. Në pjesën perëndimore të saj shtrihet një hapësirë e gjerë bregdetare përgjatë detit Jon. “Shqipëria del në plan të parë për shkak të pozitës së saj detare në Otranto, në anën tjetër të së cilës ndodhen forcat e armikut”, do të theksonte i dërguari i posaçëm gjerman në Tiranë Neubacher në kujtimet e tij. Nga ana tjetër, në Shqipërinë e Jugut, e posaçërisht në ZIOp, lëvizja partizane kishte marrë një shtrirje të gjerë, të cilën janë të detyruar ta pranojnë edhe vetë italianët shumë kohë përpara kapitullimit të tyre. Në një raport që i drejtohet qeverisë kuisling në Tiranë theksohet, qysh në shkurt 1943 se “në të vërtetë kryengritësit janë pothuajë zotër të zonave malore... Gjithë zona ... është praktikisht një territor, që sundohet nga kryengritësit”. Të njëjtën gjë thekson edhe komandanti i karabinierisë në një informacion të tij në mes të shkurtit 1943 “...pjesa më e madhe e fshatrave të Shqipërisë së Jugut gjendet në duart e partizanëve shqiptarë”. Kjo lëvizje e zgjeruar dhe e suksesshme e partizanëve shqiptarë përbënte një pengesë të madhe për realizimin e detyrës që shtronte Vermahti para grupimit të forcave të vetme në Shqipëri për përballimin e një zbarkimi të mundshëm detar aleat. Ata kërkonin e luftonin që hapësira në lindje të vijës bregdetare të ishte e qetë dhe e pastër nga forcat partizane. Mbështetur në detyrën që kishte vënë Hitleri “për çarmatosjen e shqiptarëve dhe të çetave shqiptare”, komanda gjermane në Shqipëri do të ndërmerrte menjëherë operacione për asgjësimin e forcave partizane dhe çarmatosjen e popullsisë. Në ZIOp vepronin forca të konsiderueshme të vetë zonës dhe të UNÇSH, e cila kishte të shpërndara në këtë zonë Br. I e V S dhe ishte duke krijuar Br. VI S. Në këtë mënyrë Gr.1 e 2P të ZIOp me batalione nga më të vjetrit dhe më me përvojë luftarake në zonë, si dhe disa batalione të grupeve të tjera ishin përfshirë në përbërje të Br.V e VI S, të cilat përbëheshin tërësisht nga partizanë të formacioneve luftarake të ZIOp. Ndërkohë komanda e zonës kishte marrë masa për krijimin e formacioneve të reja partizane, duke kompletuar grupet e batalionit me forca të reja dhe duke zgjeruar batalionet territoriale. Rugët e lëvizjes gjendeshin nën kontrollin e forcave partizane. Në tërësi në krahinën e Mesaplikut, këshillat NÇ të fshatrave ushtronin pushtetin e tyre. Faza e parë e operacionit “Horridoh” përfshinte rigrupimin e forcave për zënien e bazës së nisjes si dhe ndërmarrjen e disa veprimeve të pjesshme për pastrimin e krahinës nga forcat partizane dhe kapjen e vijave të përshtatshme e sigurimin e krahëve të forcave të veta. Në drejtimet e lëvizjes së tyre ato do të bënin edhe pastrimin e krahinave nga forcat partizane. Në të tria drejtimet u zhvilluan luftime të ashpra, të cilat janë



Duke kujtuar operacionin gjerman në Lumin e Vlorës, 70 vjet më pas

të detyruar t'i pranojnë edhe vetë gjermanët. Batalioni “Perlat Rexhepi” i Gr. 2 P dhe b2 Br. V S më 22-23 janar 1944 zhvilluan veprime të ashpra në rajonin e Vajzës me b3 R 54, veçanërisht më datë 24 janar 1944. Faza e dytë e operacionit “Horridoh” (25-29 janar 1944) u realizua me gjashtë batalione të Div. 1 Malor të K-XXII dhe pjesërisht të Div.100 të K-XXII. Për komandimin e operacionit u caktua komanda e Div. “Shtajrier”, i cili vendkomandën e vendosi në qytetin e Gjirokastrës. U përdor metoda e “fshirjes”, si më efikase në kushtet e terrenit. Kushtet e vështira të dimrit dhe terreni i ashpër malor vështirësonin shumë veprimet e forcave partizane, qoftë edhe lëvizjen e tyre. Oficeri i misionit anglez pranë shtabit të ZIOp Tilman, pjesëmarrës aktiv në këtë manovrim, thekson në librin e tij “Kur njerëzit takohen me malet”, se “ishte një pikëpyetje të përcaktoje se kush meritonte më shumë simpati, partizanë me gjymtyrë të thyer apo ata që mbanin mbi supe vigjet me të plagosur gjatë errësirës dhe të mbytur në djersë, që me zor mbaheshin në këmbë për shkak të akullit rrëshqitës”. Në të gjithë zonën, gjatë Fazës së Dytë të operacionit forcat partizane zhvillonin luftime këmbëngulëse kundër armikut me epërsi në forca e mjete. Me qëllim që t'i shmangeshin veprimeve luftarake ballore dhe për t'i shpëtuat rrethimit, në tërësi forcat më 28 janar 1944 shkëputën kontaktin luftarak me armikun dhe dolën në rajonet e caktuara. Në kushtet kur forcat gjermane po kapnin gjithë hapësirën e parashikuar, edhe këto forca më datë 29 janar 1944 shkëputën kontaktin, duke dalë në krahë e shpinë të armikut. Forcat partizane dhe forcat territoriale u shpërndanë me grupe të vogla dhe manovruan brenda krahinës së Mesaplikut. Për të justifi-

kuar mosplotësimin e detyrës, komanda gjermane raportonte shifra të zmadhuara për sasinë e forcave partizane, madje në 4000-5000 veta. Për veprimet në Fazën e Tretë (Mesaplik, Tepelenë, Kurvelesh e Bregdet), komanda gjermane synonte të shtynte forcat partizane nëpërmjet goditjeve koncentrike në lartësitë e Kurveleshit të Sipërm dhe, pasi të mbyllte shtigjet e tërheqjes së tyre, të kalonte në asgjësimin e plotë. Në drejtimin e Luginës së Shushicës komanda gjermane vendosi të fillojë mësymjen që më 29 janar 1944 ose 5 ditë përpara se në drejtimet e tjera. Kjo bëhej me qëllim që të shtynte forcat partizane në Lumin e Vlorës për në drejtim të Kurveleshit të Poshtëm dhe të bllokonte rrugët e tërheqjes së mundshme të forcave partizane në drejtimin Kuç-Borsh. Në bregdet, edhe pse nuk kishte plan të ndërmerrte veprime mësymëse, ajo bëri disa veprime demonstrative për të mashtuar forcat partizane për mos dalë në bregdet. Në hapësirën ku do të kryhej faza e tretë e operacionit, vepronin forcat e Gr. 2, 3, 4P të ZIOp dhe Br. V S e forcat territoriale të zonës të shpërndara në një hapësirë të madhe. Komanda e shtabi i ZIOp e kishte shumë të vështirë t'u jepte udhëzime forcave për mungesë ndërlik-hjeje dhe të dimrit të madh. Mbështetur në udhëzimet e dhëna para operacionit armik për një situatë të tillë të pritshme, komandat e batalioneve vepruan me nismë, duke shpërndarë forcat me nënreparte e deri grupe të vogla, duke caktuar edhe përfaqësues të shtabit të batalioneve nëpër kompani. Ndërkohë bp “Perlat Rexhepi” i Gr. 2P që më datë 29 janar 1944 kishte shkëputur kontaktin, me urdhër, kur luftimet zhvilloheshin në zonën e Velçës për të dalë në shpinë të armikut. Po kështu në Delvinë Gr. 4P, më 30-31 janar 1944

bllokoi në atë rajon grupimin gjermano-ballist, i cili synonte të shtynte forcat partizane drejt veriut. Më 17 shkurt 1944 forcat gjermane u larguan nga Mesapliku e Kurveleshi. Komanda e ZIOp, Br. V S dhe një batalion i Br. VI S, deri më 20 shkurt 1944, spastruan krahinën ku u zhvillua operacioni. Për të ulur efektet e goditjeve të komandës gjermane në etapën e parë të operacionit mësymës dhe për të çoroditur atë, komanda e ZIOp ndërmori një zinxhir goditjesh të pjesshme e pritash në gjithë zonën. Një dukuri e re gjatë përbalimit të Mësymjes së Përgjithshme gjermane të Dimrit në ZIOp ishte pjesëmarrja në luftime e forcave të tri brigadave sulmuese: si një pjesë e forcave të Br.I S dhe gjithë forcat e Br. V, VI S, të cilat u krijuan në luftime e sipër dhe, sipas detyrës së vënë nga SHPUNÇSH, do të vepronin në rajonet ku u krijuan. Nga njëra ana, kjo krijoi një gjendje të re e më të lartë cilësore ushtarak në hapësirat e ZIOp, por, nga ana tjetër, ajo ndikoi edhe në uljen e intesitetit luftarake të disa grupeve të zonës. Br. V, VI S u krijuan kryesisht me partizanë të grupeve partizane të kësaj zone, si dhe me luftëtarë të rinj. Disa batalione të tyre u rreshtuan në përbërje të brigadave. Por ato në tërësi ruajtën edhe strukturën luftarake të grupit dhe të batalionit, që e përbënin atë. Por si forca luftarake ato kishin vetëm një bërthamë të vogël luftëtarësh, që nuk mund të kryenin detyra të rëndësishme luftarake. Gjithsesi, ato do të shërbenin si bazë për rikrijimin e ri-kompletimin e tyre në fazat e mëvonshme të luftimeve. Operacioni i Dimrit këto grupe i zuri në riorganizim e sipër dhe nuk u arrit që të plotësoheshin me efektiv. Por menjëherë pas përfundimit të etapës së dytë të operacionit gjerman në muajt mars-prill 1944, komanda e ZIOp mori

masa të menjëhershme për ri-kompletimin e tyre dhe futjen gjerësisht në veprime luftarake në kuadrin e kundërmësymjes së UNÇSH. Prania e forcave të brigadave sulmuese në ZIOp dhe kryerja e detyrave të përbashkëta luftarake shtroi nevojën e organizimit të një bashkëveprimi të hollësishëm në mes tyre. Për këtë edhe në çdo luftim të përbashkët u krijuan komanda apo shtabe operative, të cilat koordinonin veprimet luftarake. Krijimi i tyre ndikoi pozitivisht në ecurinë e veprimeve luftarake e veçanërisht për të mos lejuar rënien e forcave partizane në gjendje të vështira e në rrethim gjatë veprimeve krahë e shpinëmarrëse të armikut, kur ata arrinin të pikëzonin në njërin a tjetrin drejtim, sikurse u veprua në luginën e Shushicës. Por bashkëveprimi u shtri edhe nëpërmjet forcave të brigadave dhe atyre territoriale në rajonin e veprimeve luftarake. Me gjithë pjesëmarrjen e gjerë të forcave, veprimet luftarake në ZIOp, mbështetur në detyrat e vëna nga Shtabi i Përgjithshëm, edhe pse u zhvilluan në një hapësirë të gjerë nga Vlorë e deri në Konispol, ato u zhvilluan mbi bazën e një ideje dhe qëllimi të caktuar, duke dhënë rezultatet e pritshme dhe krijuan në kuadrin e UNÇSH kushtet e përshtatshme për kalimin në mësymje të UNÇSH. Në kushtet e epërsisë së armikut në forca e mjete, si dhe për të shmangur dëmtimin e asgjësimin e forcave partizane, komanda e ZIOp dhe ato të brigadave, duke u mbështetur në veprimet luftarake mbrojtëse, u dhanë atyre karakter të theksuar manovrues. Trupat kalonin në mbrojtje dhe kryenin veprime luftarake mbrojtëse vetëm për aq kohë sa e shikonin veten të aftë të përballonin armikun. Kur gjendja përkeqësohej, ato shkëpusnin kontaktin luftarak dhe dilnin në krahë e shpinë të armikut për të dhënë goditje të reja atje dhe atëherë kur ai nuk e priste. Mbështetur në detyrat e vëna, komandat partizane manovrimin e forcave e bënin kryesisht në krahinën e caktuar për veprime luftarake, në mënyrë që ajo të mos mbetej bosh dhe armiku të mos ta ndjente veten të qetë. Edhe kur Br. VI S u zhvendos në Frashër, në rezultat të presionit të forcave gjermane, ajo menjëherë në ditët e para të shkurtit u rikthy në zonën e Gjirokastrës, ku kaloi në veprime luftarake mësymëse për rimarrjen e zonave të pushtuara nga gjermanët e duke i spastruar ato nga forcat balliste. Kështu vepruan në çdo rast veçanërisht forcat e grupeve të ZIOp si Gr. 3, 4, 5P dhe pjesërisht të Gr. 2P. Për daljen e forcave në krahë e në shpinë të armikut, forcat në tërësi ruajtën kompaktësinë e tyre luftarake. Por kur gjendja ishte e vështirë dhe dalja në krahë e në shpinë të armikut me formacione kompakte ishte e pamundur, atëherë formacionet u copëtuan më tej si Batalioni “Misto Mame” (një pjesë e tij) gjatë luftimeve në Lunxhëri, apo forcat e Br. V S gjatë fazës së fundit të operacionit gjerman në luginën e Shushicës ku ato dolën edhe me grupe të vogla dhe arritën të bashkohen me formacionet e tyre, një pjesë edhe pas disa ditësh (10-15 ditë). Armiku në mësymjen e tij të përgjithshme nuk arriti të realizojë objektivat kryesore, atë të asgjësimit të forcave dhe të mjeteve të formacioneve partizane. Kjo u arrit në sajë të elasticitetit të forcave partizane, të njohjes së terrenit, të manovrimit të shpejtë, të mbështetjes nga populli dhe të zotërimit të situatës në tërësi, si nga forcat partizane dhe nga pushteti i prapavijave. Tani pas 70 vjetësh të këtyre luftimeve e operacioneve, kjo hapësirë e Lumit të Vlorës i përkujton këto ngjarje me shpresën se një ditë do ta shikojnë këtë zonë: të begatë, me rrugë e ndërtime të reja, me fshatra të sistemuar dhe me prodhime të bollshme... me lapidarë dhe përmen-dore të sistemuara, me muze dhe turizëm malor të zhvilluar...

26-27 shkurt 2014

NATO - OTAN

Ministeriali i Mbrojtjes së Vendeve të NATO-s

Në këtë ministerial, krahas të tjerave pati edhe një ngjarje e cila shënoi një rekord, apo më mirë herën e parë të një ndodhie në NATO. Në këtë mbledhje politikë-bërje, u shënuua hera e parë, që NATO kishte në një mbledhje të nivelit të lartë, pesë gra në funksionin e ministres së Mbrojtjes. Këtë gjë e vunë në dukje edhe mediet e rrethit ndërkombëtar. Ministria e fundit e cila i është bashkuar këtij grupi është ajo e Italisë, Roberta Pinotti. Ajo e bëri betimin si ministria e parë e Mbrojtjes e vendit të saj, ditën e diel. Italia 52 vjeçare ka shërbyer më parë si zëvendësinistër e Mbrojtjes në qeverinë e Enriko Letas. Pinotti u bashkua ministres shqiptare Mimi Kodheli, gjermanes Ursula von der Leyen, norvegjezes Ine Marie Erikssen Soreide dhe holandezes Jeanine Hennis-Plasschaert. Ky është numri më i madh i pjesëmarrjes femërore si ministër Mbrojtje në të njëjtën kohë në Aleancë, qysh nga krijimi i NATO-s, viti 1949. Para se t'i futeshin punës me kolegët e tyre meshkuj, pasditen e të mërkurës, ministret e Mbrojtjes u mbledhën për ta memORIZUAR këtë çast duke u vendosur përpara fotografave të agjencive të lajmeve. Fillimisht ishin veç katër prej tyre, por ministria norvegjeze vuri re mungesën e ministres Kodheli dhe në këtë mënyrë e lajmëruan me shpejtësi, me qëllim që grupi i tyre të ishte i plotë. Në këtë mënyrë u bë fotoja e pesë ministresve të Mbrojtjes, të cilat për herë të parë krijuan një numër të tillë përfaqësimit në NATO.

FOTO, nga e majta në të djathtë: Mimi Kodheli (ministër e Mbrojtjes, Shqipëri); Jeanine Hennis-Plasschaert (ministër e Mbrojtjes, Holanda); Ursula von der Leyen (ministër e Mbrojtjes, Gjermani); Ine Marie Erikssen Soreide (ministër e Mbrojtjes, Norvegji) dhe Roberta Pinotti (ministër e Mbrojtjes, Itali)

